



Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale  
Državna Agencija za Zaštitu Ličnih Podataka  
National Agency for Protection of Personal Data

## **Raport Vjetor i Punës**

---

Për vitin 2018



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova-Republic of Kosovo



**Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale**  
Državna Agencija za Zaštitu Ličnih Podataka  
National Agency for Protection of Personal Data

***RAPORTI VJETOR I PUNËS  
PËR VITIN 2018***

***PRISHTINË  
Mars, 2018***



## Tabela e Përmbajtjes

1	Përmbledhje Ekzekutive .....	4
2	Korniza Ligjore.....	5
2.1	Aktet Nënligjore të Agjencisë .....	5
2.2	Përmirësimi i Bazës Ligjore në Periudhën Raportuese.....	6
3	Përshkrimi i Institucionit (Organizimi Institucional).....	7
3.1	Përgjegjësitë.....	7
3.2	Autorizimet .....	8
3.3	Misioni .....	8
3.4	Vizioni .....	8
3.5	Objektivat .....	9
4	Fushëveprimi i Agjencisë .....	9
4.1	Organizimi i Agjencisë .....	9
4.2	Agjencia .....	10
4.2.1	Mandati .....	10
4.2.2	Kompetencat.....	10
4.2.3	Ekzekutivi .....	10
4.3	Burimet Njerëzore .....	12
4.3.1	Nevojat për Punonjës të Rinj .....	12
4.3.2	Plani i Trajnimit për Personelin e Angazhuar në Kuadër të ASHMDHP-së për Vitin 2018 .....	13
4.3.3	Asetet .....	13
5	Aktivitetet e Agjencisë në Fushën e Mbrojtjes së të Dhënave Personale.....	14
5.1	Këshilla dhe Opinione .....	14
5.2	Këshillat e Agjencisë .....	15
5.3	Konsultim me Rastin e Hartimit të Masave Legjislative dhe Administrative .....	15
5.4	Ankesat .....	21
5.5	Inspektimi dhe Kontrolli .....	22
5.5.1	Përpunimi i të Dhënave Biometrike .....	22
5.5.2	Transferimi i të Dhënave Personale .....	23
5.6	Informimi dhe Promovimi.....	24
5.7	Bashkëpunimi Vendor dhe Ndërkombëtar .....	27



5.8	Bashkëpunimi me Zyrtarët e Mbrojtjes së të Dhënave .....	28
5.9	Regjistrimi i Sistemit të Dosjeve .....	29
6	Vlerësimet e Përgjithshme dhe Rekomandimet për Mbrojtjen e të Dhënave Personale .....	29
7	Raporti Financiar .....	31
7.1	Përmbledhje të Zhvillimeve Kryesore për Buxhetin.....	31
7.2	Përmbledhje për të Hyrat dhe Kategoritë e Veçanta të Shpenzimeve.....	31
7.3	Përmbledhje e Vërejtjeve Përfundimtare dhe Pikëpamjet për Zhvillimet e Ardhshme .....	32
7.3.1	Objektivat e Vazhdueshme.....	33
7.4	Tabelat 4- Detajet e Shpenzimeve. Sipas Kodeve Ekonomike .....	34
7.4.1	Shpenzimet e Përgjithshme .....	34
7.4.2	Mallra dhe Shërbime .....	35
7.4.3	Shpenzimet Komunale .....	41
7.4.4	Investimet Kapitale.....	41
7.4.5	Subvencione dhe Transfere .....	42
	Agjencia nuk ka pasur buxhet të paraparë në Subvencione dhe Transfere...	42
7.4.6	Personeli dhe Struktura e Pagave.....	42
8	Raportimi rreth Adresimit të Rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm	43



# 1 Përmbledhje Ekzekutive

Në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Agjencia për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, paraqet para Kuvendit të Republikës së Kosovës raportin e punës rreth aktiviteteve të përgjithshme për vitin 2018. Me këtë raport, Agjencia paraqet pasqyrën e përgjithshme të zhvillimeve dhe aktiviteteve të saj në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, si dhe para deputetëve të Kuvendit, nxjerr vlerësimet e veta, duke dhënë rekomandimet e nevojshme në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale.

Në raport do të gjeni përshkrimin e shkurtë të akteve ligjore në fuqi që rregullojnë funksionimin e Agjencisë dhe njëkohësisht japin bazamentin orientues lidhur me parimet e përpunimit të të dhënave personale. Kjo kornizë ligjore, gjithashtu, përshkruan organizimin, fushëveprimin, përgjegjësitë, autorizimet dhe detyrimet ligjore ndaj subjekteve të të dhënave personale. Përshkrimi i aktiviteteve në raportin e punës është bërë në përputhje me planin e punës (2018) dhe objektivat e Strategjisë (2016-2019); duke përfshirë këtu: kontrollet, trajtimin e ankesave, këshillat, rekomandimet, opinionet, ndërgjegjësimin, ngritjen profesionale (trajnimet), promovimin, bashkëpunimin ndërinstytucional dhe bashkëpunimin rajonal e ndërkombëtar.

Sipas kërkesës standarde të raportimit, raporti, në fund, jep edhe pasqyrën e vlerësimeve të Zyrës Kombëtare të Auditimit për Agjencinë si dhe pasqyrat financiare të këtij institucioni për vitin 2018.

Siç është konfirmuar edhe nga rekomandimet e vazhdueshme të Komisionit Evropian, sfida kryesore për vitin 2018 ishte ndryshimi i ligjit, shtimi i personelit dhe buxhetit të Agjencisë, sfida të cilat janë bartur në vitin 2019. Me aprovimin e Ligjit Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në janar 2019, obligim i Agjencisë është që brenda gjashtë muajve të hartojë aktet e reja nënligjore dhe t'i përgatisë për miratim rregulloren për organizim të brendshëm pas emërimit të Komisionerit.

Ndërsa, nën prizmin e fokusimeve të jashtme të shoqërisë civile dhe medimeve, në respektim të kërkesave për qasje në dokumente publike, edhe pse Agjencia nuk kishte mandat për zbatimin e ligjit që rregullon këtë fushë, në balancimin e dy të drejtave (mbrojtja e të dhënave personale dhe qasja në dokumentet publike), ajo, me përkushtim ka dhënë këshilla e opinione, duke dhënë kështu kontribut të veçantë në këtë drejtim.

Promovimi i të drejtës për mbrojtje të të dhënave personale dhe ndërgjegjësimi i publikut ishte fokus i Agjencisë, për të cilat, raporti, në mënyrë analitike, sjell të dhëna faktike. Caktimi i zyrtarit për mbrojtjen e të dhënave personale në institucionet publike është një proces i vazhdueshëm.

Agjencia ka mbështetur grupin punues përmes organizimit të takimeve dhe mbulimin e shqenczimeve. Gjithashtu, ka dhënë kontribut shumë të madh me propozimet që ka bërë në Projekt-Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, si fushë specifike, duke bërë propozime të cilat janë edhe pjesë e *Acquis Communautaire* të harmonizuara me Rregulloren (EU) 2016/679 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të datës 27 prill 2016, mbi mbrojtjen e personave fizikë, për sa i përket përpunimit të të dhënave personale dhe qarkullimit të lirë të këtyre të dhënave.

## 2 Korniza Ligjore

Në Republikën e Kosovës, e drejta për mbrojtjen e të dhënave personale dhe privatësisë është e drejtë e garantuar me Kushtetutë dhe me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Kjo e drejtë, e garantuar me nenin 36 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, përfshinë respektimin e jetës private dhe familjare, pacenueshmërinë e banesës, fshehtësinë e korrespondencës, telefonisë dhe komunikimeve të tjera dhe mbrojtjen e të dhënave personale.

Gjithashtu, zbatimi i drejtpërdrejtë i marrëveshjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare që garantojnë të drejtat dhe liritë e njeriut, të përcaktuara me nenin 22 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, siç janë:

- 1) Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut;
- 2) Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollat e saj;

Në bazë të nenit 53 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut janë drejtpërdrejt të aplikueshme edhe në vendin tonë.

Në vitin 2010, Kuvendi i Republikës së Kosovës miratoi Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (03/L-172), i cili përcakton të drejtat, përgjegjësitë, parimet dhe masat lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale dhe themeloi institucionin që është përgjegjës për mbikëqyrjen e legjitimitetit të përpunimit të të dhënave. Me aprovimin e Ligjit Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në janar 2019, nga tani e tutje, Agjencia për Informim dhe Privatësi (e transformuar nga Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale) është institucion shtetëror i pavarur, i themeluar në bazë të Ligjit Nr.06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe është përgjegjëse për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për qasje në dokumente publike dhe mbrojtjen e të dhënave personale, me qëllim që të mbrohen të drejtat dhe liritë themelore të personave fizikë, në lidhje me përpunimin e të dhënave personale dhe garantimin e qasjes në dokumente publike.

Këshillëdhënia për organet publike dhe private, marrja e vendimeve për ankesat e paraqitura, inspektimet dhe kontrollat, informimi i publikut, shqiptimi i masave ndëshkuese, bashkëpunimi me autoritete homologe evropiane, certifikimi i kontrolluesve, si dhe promovimi e përkrahja e të drejtave themelore për mbrojtjen e të dhënave personale janë pjesë e kompetencave së Agjencisë.

Legjislacioni primar dhe sekondar, i cili rregullon përpunimin e të dhënave personale, duhet të jetë në harmoni me parimet e përcaktuara me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Obligim i Agjencisë është që brenda gjashtë muajve të hartojë aktet e reja nënligjore dhe t'i përgatisë për miratim pas emërimit të Komisionerit.

### 2.1 Aktet Nënligjore të Agjencisë

Në harmoni me nenin 94 të Ligjit Nr. 03 /L-172 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, me qëllim të zbatimit të ligjit, Agjencia ka nxjerrë akte nënligjore dhe dokumente përcjellëse administrative.

#### Aktet Nënligjore

1. Rregullorja e Punës e Agjencisë Nr. 20/2011;
2. Rregullorja Nr. 01/2012 për Mënyrën e Kryerjes së Inspektimit dhe Kontrollit;
3. Rregullorja Nr. 03/2012 mbi Procedurën e Brendshme të Shqyrtimit të Kërkesave për Lejimin e Transferimit Ndërkombëtar të të Dhënave Personale;



4. Rregullorja Nr. 01/2013 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës;
5. Rregullorja nr. 01/2015 për Mënyrën e Ruajtjes dhe Shfrytëzimit të Materialit Arkivor dhe të Protokollit;
6. Rregullorja Nr. 02/2015 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr.03/2012 mbi Procedurën e Brendshme të Shqyrtimit të Kërkesave për Lejimin e Transferimit Ndërkombëtar të të Dhënave Personale;
7. Rregullorja Nr. 03/2015 mbi Masat e Sigurisë gjatë Përpunimit të të Dhënave Personale;
8. Rregullorja Nr. 04/2015 për Procedurat e Brendshme për Shqyrtimin e Ankesave;
9. Rregullorja Nr. 05/2015 për Mënyrën e Mbajtjes së Regjistrit të Sistemit të Dosjeve të të Dhënave Personale dhe Formularit Përkates të Regjistrit;
10. Rregullorja Nr. 06/2015 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr.03/2015 mbi Masat e Sigurisë gjatë Përpunimit të të Dhënave Personale;
11. Udhëzimi Administrativ për Kartelat Zyrtare të Mbikëqyrësve Shtetërorë 03/2012; (i miratuar nga Qeveria me propozim të Agjencisë, konform nenit 47 të Ligjit nr. 03/L-172);
12. Udhëzimi Administrativ Nr. 01/2014 për Avanse, Reprerentacion, Telefoni Fikse dhe Mobile;
13. Udhëzimi Administrativ nr. 01/2015 për Procedurat e Brendshme për Shqyrtimin e Pyetjeve të Ardhura në Agjenci dhe Aplikimet për Dokumente Publike;
14. Kodi i Etikës për Punonjësit e Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale;

### **Dokumente Përcjellëse Administrative**

- Formulari i Ankesës.
- Formulari i Procesverbalit të Inspektimit dhe Kontrollit.
- Formulari për Lejimin e Transferimit Ndërkombëtar të të Dhënave.
- Listat e Kontrollit:
  1. Lista e kontrollit për sektorin shëndetësor;
  2. Lista e kontrollit për sistemin e kadastrit;
  3. Lista e kontrollit për regjistrin civil;
  4. Lista e kontrollit për regjistrin penal;
  5. Lista e kontrollit për sektorin financiar;
  6. Lista e kontrollit për sigurimet shëndetësore.
- Formulari i Kërkesës për Regjistrim të Kontrolluesve.
- Lista e Kontrollit "Pajtueshmëria e Akteve Ligjore dhe Nënligjore me Ligjin Nr. 03 / L-172 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

## **2.2 Përmirësimi i Bazës Ligjore në Periudhën Raportuese**

Agjencia, gjatë periudhës raportuese, ka marrë pjesë në Grupin Punues për Hartimin e ligjit - për plotësim - ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-172 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Me vendim ref.075/2017 datë 03.05.2017 të Sekretarit të Përgjithshëm të Zyrës së Kryeministrit është themeluar ekipi i Punues për hartimin e draftit fillestar të projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-172 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Më 15.05.2017, Qeveria e Republikës së Kosovës ka marrë vendim Nr. 03/145, duke aprovuar Koncept - Dokumentin për Qasje në Dokumente Publike. Në koncept dokument është përcaktuar që



mbikëqyrja e zbatimit të këtij ligji të jetë kompetencë e Agjencisë. Po ashtu, në Programin Legjislativ të Qeverisë janë paraparë që të plotësohen dhe ndryshohen 2 ligjet: Ligji Nr. 03/L-172 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Ligji Nr.03/L-215 për Qasje në Dokumente Publike.

Agjencia ka mbështetur grupin punues, përmes organizimit të takimeve, gjithashtu ka dhënë kontribut shumë të madh me propozimet që ka bërë në Draft - Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, si fushë specifike, duke bërë propozime, të cilat janë edhe pjesë e *Acquis Communautaire* të harmonizuara me Rregulloren (EU) 2016/679 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të datës 27 prill 2016, mbi mbrojtjen e personave fizikë, për sa i përket përpunimit të të dhënave personale dhe qarkullimit të lirë të këtyre të dhënave.

Ligji Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka hyrë në fuqi me datë 11.03.2019, duke përcaktuar kompetencat dhe detyrat shtesë të Agjencisë, për mbikëqyrjen e zbatimit të dy të drejtave themelore kushtetuese, privatësisë dhe mbrojtjes së të dhënave personale dhe legjislacionit për qasje në dokumente publike, sipas ligjit për qasje në dokumente publike, i cili pritet që së shpejti të kalojë në lexim të dytë në Kuvendin e Kosovës.

Neni 108 i ligjit ka rregulluar bartjen e asetëve, të drejtave dhe detyrimeve, buxhetit dhe personelit duke përcaktuar se *me hyrjen në fuqi të këtij ligji, të gjitha asetet fizike, të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga kontratat e lidhura dhe ndarjet buxhetore të Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, i barten Agjencisë për Informim dhe Privatësi.*

Sipas ligjit të ri ndryshon edhe organizimi i Agjencisë, ku pritet që të kemi një organogram me strukturë dhe kompetenca të reja e që për këtë duhen kapacitete të reja njerëzore dhe mjete shtesë financiare, në mënyrë që të fillohet me hartimin dhe nxjerrjen e akteve nënligjore për mbikëqyrjen e zbatimit të këtyre ligjeve. Ngritja e njohurive dhe kapaciteteve të stafit aktual është gjithashtu e domosdoshme, duke e ditur se ligji i ri ka sjellë disa risi, nocione dhe parime të reja në fushën e mbrojtjes dhe përpunimit të të dhënave personale, sigurisë së përpunimit, aktiviteteteve përpunuese, trajtimin e ankesave, e deri te shqiptimi i masave ndëshkuese për shkelësit e ligjit.

### 3 Përshkrimi i Institucionit (Organizimi Institucional)

#### 3.1 Përgjegjësitë

Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale është institucion shtetëror i pavarur, i themeluar në bazë të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe është përgjegjëse për mbikëqyrjen e legjitimitetit të përpunimit të të dhënave personale.

Agjencia këshillon Kuvendin e Kosovës, Qeverinë, organet e pushtetit lokal, organet e tjera shtetërore, ushtruesit e pushtetit publik si dhe organizatat private, për të gjitha çështjet e lidhura me mbrojtjen e të dhënave personale, duke përfshirë interpretimin dhe zbatimin e ligjeve përkatëse që rregullojnë përpunimin e të dhënave personale. Agjencia duhet të konsultohet nga Kuvendi i Kosovës dhe Qeveria e Kosovës, me rastin e hartimit të masave legjislative dhe administrative që kanë të bëjnë me përpunimin e të dhënave personale.

Agjencia vendosë lidhur me ankesat e personave nëse ai ose ajo konsideron se e drejta e tij/saj për mbrojtjen e të dhënave është shkelur, si dhe informon ankuesin lidhur me rezultatin dhe masat e





ndërmarra; Jep pëlqimin lidhur me krijimin e sistemit të dosjeve si dhe krijon dhe mirëmbanë regjistrin e sistemit të dosjeve; Mbikëqyrë procedurat dhe masat e duhura organizative, teknike dhe logjistike-teknike për sigurimin e të dhënave personale; Kryen inspektime dhe kontrolle për të mbikëqyrur zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, si dhe të cilitdo ligj apo rregullore që rregullon përpunimin e të dhënave personale.

Agjencia bashkëpunon me organet shtetërore, ndërkombëtare dhe organet e Bashkimit Evropian lidhur me çështjet që konsiderohen të rëndësishme për mbrojtjen e të dhënave personale; Mbikëqyrë zbatimin e dispozitave lidhur me transferimin e të dhënave; Parashtron kërkesë pranë Gjykatës Kushtetuese të Kosovës për të vlerësuar kushtetutshmërinë e ligjeve, rregulloreve dhe akteve tjera kur konsideron se ato nuk janë në harmoni me të drejtën për mbrojtjen e të dhënave, siç parashihet në nenin 36 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës; Përpilon planin vjetor të punës si dhe paraqet para Kuvendit raportin vjetor të punës në lidhje me zhvillimet, vlerësimet dhe rekomandimet në fushën e mbrojtjes së të dhënave, si dhe të njëjtin e bën publik; Ia propozon Kuvendit buxhetin për nevojat vjetore të Agjencisë; Nxjerr akte nënligjore me qëllim të zbatimit të ligjit, etj.

### 3.2 Autorizimet

Me qëllim të përmbushjes së detyrimeve ligjore, Agjencia kryen inspektime dhe kontrolle. Inspektimet dhe kontrollet kryhen drejtpërdrejt nga Agjencia. Në këtë kuadër, Agjencia ka të drejtë të kontrollojë dhe konfiskojë çdo dokumentacion që ka të bëjë me përpunimin e të dhënave personale, pavarësisht nga besueshmëria ose fshehtësia e tij; Të kontrollojë përmbajtjen e sistemeve të dosjeve, pavarësisht nga besueshmëria ose fshehtësia e tyre dhe katalogjet e sistemeve të dosjeve; Të kontrollojë çdo dokumentacion dhe udhëzim që rregullon sigurinë e të dhënave personale; Të kontrollojë ndërtesën në të cilën përpunohen të dhënat personale dhe ka të drejtë të kontrollojë dhe të konfiskojë kompjuterët dhe çfarëdo pajisje tjetër, si dhe dokumentacionin teknik; Të verifikojë masat dhe procedurat që kanë për qëllim sigurimin e të dhënave personale dhe zbatimin e tyre; Të kryejë çdo detyrë tjetër që konsiderohet e rëndësishme për kryerjen e inspektimeve dhe kontrolleve të parapara me këtë ligj.

### 3.3 Misioni

Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, duke pasur status të pavarur, ka përgjegjësinë ligjore për mbikëqyrjen e legjitimitetit të përpunimit të të dhënave personale. Këshillimi i organeve publike dhe private, marrja e vendimeve për ankesat e paraqitura, inspektimet dhe kontrollet, informimi i publikut, si dhe promovimi e përkrahja e të drejtave themelore për mbrojtjen e të dhënave personale janë pjesë e fushëveprimtarisë kryesore në kuadër të misionit të Agjencisë.

### 3.4 Vizioni

Me qëllim të përmbushjes së misionit të saj, sipas strategjisë së aprovuar, Agjencia synon të realizojë këto objektiva: Harmonizimin e plotë të kornizës ligjore me *Acquis Communautaire* të BE-së; Ndërgjegjësimin e qytetarëve për të drejtën e mbrojtjes së të dhënave personale dhe privatësisë; Mbikëqyrjen e ligjshmërisë së përpunimit të të dhënave përmes inspektimeve dhe kontrolleve; Thellimin e bashkëpunimit dhe bashkërendimit të punëve me organet dhe institucionet tjera, si dhe



me mekanizmat dhe institucionet ndërkombëtare, me qëllim të mbrojtjes dhe promovimit të së drejtës së mbrojtjes së të dhënave personale dhe privatësisë; Ngritjen profesionale të personelit të Agjencisë, funksionalizimin e plotë të strukturës organizative, si dhe sigurimin e hapësirave shtesë të punës; Fushatën njoftuese dhe ndërgjegjësuere për opinionin publik përmes aktiviteteve përkatëse; Mbajtjen e takimeve, konferencave; Bashkëpunimin rajonal dhe nënshkrimin e marrëveshjeve me karakter rajonal dhe ndërkombëtar në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale; Regjistrimin e të gjitha sistemeve të dosjeve të institucioneve publike dhe private.

### 3.5 Objektivat

Mbikëqyrja e vazhdueshme e ligjshmërisë së përpunimit të të dhënave synohet të arrihet duke zhvilluar aktivitete në:

- Edukimin e organeve publiko-private;
- Ngritjen e vetëdijes së qytetarëve;
- Harmonizimin e legjislacionit me *Acquis Communautaire* të BE-së;
- Zbatimin e drejtpërdrejtë të ligjit përmes inspektimeve dhe kontrolleve;
- Trajtimin e ankesave;
- Ngritjen e kapaciteteve.

## 4 Fushëveprimi i Agjencisë

### 4.1 Organizimi i Agjencisë




Figura 1 – Organogrami i Agjencisë



Agjencia përbëhet nga Zyra e Mbikëqyresit Kryesor Shtetëror (Titullari i Institucionit), Zyra e Drejtorit të Përgjithshëm dhe Departamenteve.

Struktura organizative është si më poshtë:

- Zyra e Mbikëqyresit Kryesor Shtetëror (Titullarit të Institucionit)
- Zyra e Drejtorit të Përgjithshëm
- Departamentet
- Zyra për Mbështetje të Inspektimit

## 4.2 Agjencia

### 4.2.1 Mandati

Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, duke pasur status të pavarur, ka përgjegjësinë ligjore për mbikëqyrjen e legjitimitetit të përpunimit të të dhënave personale.

### 4.2.2 Kompetencat

- Agjencia jep këshilla për institucionet publike dhe private për të gjitha çështjet e lidhura me mbrojtjen e të dhënave personale, duke përfshirë interpretimin dhe zbatimin e ligjeve përkatëse;
- Agjencia parashtron kërkesë pranë Gjykatës Kushtetuese për të vlerësuar kushtetutshmërinë e ligjeve, rregulloreve dhe akteve tjera, kur konsideron se ato nuk janë në harmoni me të drejtën për mbrojtjen e të dhënave siç parashihet në nenin 36 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës;
- Agjencia vendosë për parashtrimin e padive në gjykatën kompetente kur konsideron se e drejta për mbrojtjen e të dhënave personale është shkelur;
- Agjencia vendosë lidhur me ankesat e parashtruara;
- Agjencia vendosë bashkëpunimin me organet shtetërore, ndërkombëtare dhe organet e Bashkimit Evropian lidhur me çështjet që konsiderohen të rëndësishme për mbrojtjen e të dhënave personale;
- Agjencia paraqet raportin vjetor të punës;
- Agjencia vendosë për publikimin e gazetës së Agjencisë dhe literaturës profesionale;
- Agjencia nxjerr akte nënligjore, autorizime dhe vendime;
- Agjencia vendosë për transferimin e të dhënave personale.

### 4.2.3 Ekzekutivi

**Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë** - Organizimi dhe përcjellja e funksionimit të mirë të Zyrës së Drejtorit të Përgjithshëm; Bashkëpunimi me departamentet dhe zyrat, sipas udhëzimeve të drejtorit të përgjithshëm, lidhur me koordinimin për realizimin e aktiviteteve të punës brenda afateve kohore; Drejtori i Përgjithshëm është përgjegjës për implementimin e një strukture të kontrollit të brendshëm financiar në organizatën buxhetore; Drejtori i Përgjithshëm ka për detyrë përmirësimin e standardeve në të gjitha shërbimet e ofruara nga institucioni; Përgatitja e analizave të nevojshme për



nevojat buxhetore dhe mbeshtetja efikase administrative; Marrja e vendimeve sipas legjislacionit përkatës për mbarëvajtjen e punës së institucionit.

**Departamentet** - departamentet janë njësi organizative të Agjencisë, udhëhiqen nga drejtorët, të cilët, për punën e tyre i raportojnë mbikëqyrësit kryesor shtetëror, kurse për çështje administrative Drejtorit të Përgjithshëm; Drejtori i departamentit është nëpunës civil i nivelit drejtues i cili menaxhon punën në departamentin e tij; Në bazë të kërkesave dhe nevojave të punës, departamentet përbëhen nga divizionet.

Në kuadër të Agjencisë ekzistojnë tri (3) departamente dhe një (1) zyrë:

- Departamenti për Regjistrim dhe Marrëdhënie me Jashtë;
- Departamenti Ligjor;
- Departamenti i Administratës;
- Zyra për Mbështetje të Inspektimit.

**Departamenti për Regjistrim dhe Marrëdhënie me Jashtë (DRMJ)** - Ushtron funksione dhe detyra ligjore, realizon një komunikim bashkëpunues me të gjitha departamentet e Agjencisë dhe me të gjithë zyrtarët për mbrojtjen e të dhënave personale të organeve publike, si dhe subjektet kontrolluese të të dhënave, duke administruar me efektivitet informacionin mbi kontrollin dhe përpunimin e të dhënave personale, me qëllim garantimin e ushtrimit të kompetencave ligjore. Ky departament përbëhet prej dy (2) divizioneve:

1. Divizioni i Teknologjisë Informative dhe Regjistrimit;
2. Divizioni për Marrëdhënie me Jashtë dhe me Publikun.

**Departamenti Ligjor (DL)** - Departamenti Ligjor është përgjegjës për hartimin e politikave dhe strategjive legjislative në bashkëpunim të ngushtë me mbikëqyrësin kryesor shtetëror, me departamentet dhe me njësitë e tjera organizative të Agjencisë, në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, hartimin dhe harmonizimin e legjislacionit primar dhe sekondar. DL përbëhet prej dy (2) divizioneve:

1. Divizioni për Hartimin dhe Harmonizimin e Legjislacionit (D.H.H.L);
2. Divizioni për Përfaqësim Gjyqësor (D.P.GJ).

**Departamenti i Administratës** - Departamenti është përgjegjës për menaxhimin dhe përkujdesjen e pasurisë së përgjithshme të Agjencisë, organizimin e hapësirave të punës, planifikimin dhe menaxhimin e buxhetit dhe financave, mbështetjen administrative dhe logjistike, ofrimin e shërbimeve të përkthimit, arkivimin si dhe shpërndarjen e materialit. Departamenti përbëhet prej dy (2) divizioneve:

1. Divizioni i Shërbimeve Financiare;
2. Divizioni për Shërbime të Përgjithshme.

**Zyra për Mbështetje të Inspektimit** - Mbështetet drejtpërdrejt inspektimin, në kryerjen e detyrave të inspektimit dhe kontroleve të të gjithë kontrolluesve publikë dhe privatë. Përgatitë këshilla në fushën e inspektimit dhe kontrollit lidhur me legjislacionin në fuqi.

Harton dhe merr pjesë aktive në hartimin e akteve nënligjore dhe akteve administrative pas kryerjes së inspektimit dhe kontroleve.

## 4.3 Burimet Njerëzore

Tabela 1 – Burimet Njerëzore

ASHMDHP	Nr i punëtorëve në Ligjin e Buxhetit	Nr aktual i punëtorëve në fillim të 2018		Nr aktual i punëtorëve në fund të vitit 2018	
		Me orar të plotë	Me orar të shkurtuar	Me orar të plotë	Me orar të shkurtuar
Funksionar Publik të Emëruar	5	0		0	
Administrata Qendrore	19	16		17	
<b>Total</b>	<b>24</b>	<b>16</b>		<b>17</b>	

### 4.3.1 Nevojat për Punonjës të Rinj

Që nga koha e themelimit, në qershor 2011, Agjencia ka funksionuar me një buxhet të kufizuar, numër të vogël të lejuar të personelit dhe për këtë arsye nuk janë funksionalizuar plotësisht ose nuk janë formësuar departamentet e parapara me strukturë organizative.

Si shkak i numrit të vogël të personelit, zyrtarët janë të angazhuar deri në pesë funksione, duke arritur edhe certifikimin në pjesën e shpenzimeve, ku vlenë të ceket se në vitin 2018 janë certifikuar të gjithë zyrtarët që i parasheh Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe përgjegjësi nga Manuali i Thesarit, përveç zyrtarit të pasurisë.

Bazuar në Rregulloren për Organizimin dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës, janë paraparë të jenë 37 zyrtarë, kurse për vitin 2018 i kemi të miratuar vetëm 19 zyrtarë (shërbyes civilë të lejuar).

Mungesa e mbështetjes së nevojshme financiare në realizimin e objektivave të parapara është një ndër sfidat kryesore në arritjen e nivelit të duhur të plotësimi të objektivave të parapara. Është pothuaj se joreale të pretendohet plotësimi i realizimit të objektivit të synuar të arritjes së nivelit të duhur të njohurive të qytetarëve për të drejtat e tyre për mbrojtjen e të dhënave personale - privatësisë dhe qasjes në dokumente publike - transparencës, nëse do të mungojnë mjetet e nevojshme për realizimin e fushatave ndërgjegjësuere.

Sfidë e vazhdueshme mbetet edhe mungesa e kapaciteteve njerëzore brenda Agjencisë. Numri i kufizuar i burimeve njerëzore përbën rrezik për mosrealizimin e objektivave të parapara për zbatimin e LMDHP-së. Ne kemi kërkuar në vazhdimësi rritjen e numrit të zyrtarëve. Tani është e domosdoshme rritja e numrit të personelit, sipas opinionit të MF-së për vlerësimin e ndikimit buxhetor për ligjet për mbrojtje dhe qasje, gjithsej si shtesë nga viti 2020 parashihet të jenë 17 (shtatëmbëdhjetë) pozita dhe rritjen e buxhetit në mallra dhe shërbime, bazuar në fushëveprimtarinë e veçantë të Agjencisë.

Primar për fillimin e zbatimit të ligjeve është krijimi i inspektoratit, i cili është përgjegjës për inspektimin dhe kontrollin e kontrolluesve publikë dhe privatë, si dhe misionet diplomatike dhe konsullore të Republikës së Kosovës.

Zhvillimi i hovshëm në menaxhimin e të dhënave personale përmes teknologjisë dhe pamundësia që të jemi në hap me kohën dhe realizimin e objektivave bazë që përmbushin fushëveprimtarinë e Agjencisë, vet mungesa buxhetore në kategorinë 'mallra dhe shërbime', përcakton projektet të cilat nuk mund të realizojë Agjencia, e vetme.



### 4.3.2 Plani i Trajnimit për Personelin e Angazhuar në Kuadër të ASHMDHP-së për Vitin 2018

Plani i trajnimit për vitin 2018 parasheh nevojat për ngritje të kapaciteteve në aspektin e përgjithshëm të ngritjes profesionale për të gjithë stafin e Agjencisë, që në këtë aspekt janë mbajtur trajnime për teknologji informative, siguri të përpunimit të të dhënave dhe hartimit të legjislacionit sekondar dhe akteve tjera, menaxhim të administratës, menaxhim të financave, etj. Pjesëmarrja në këto kurse trajnimi varet nga dy (2) faktorë: disponueshmërisë së fondeve dhe disponueshmërisë së kurseve të trajnimit.

Duke marrë parasysh të gjitha këto çështje, plani i trajnimit është ndarë në katër pjesë:

- I. Plani i trajnimit për personelin e angazhuar në ASHMDHP, për periudhën janar 2018 – dhjetor 2018, aktivitetet më të rëndësishme të trajnimit, të planifikuar për muaj të caktuar ose një afat për finalizimin e tyre;
- II. Aktivitetet e trajnimit në vendin e punës që janë në vazhdim e sipër dhe zakonisht ofrohen sipas kërkesës;
- III. Kurse të mëtejme për shqyrtim, varësisht nga burimet dhe disponueshmëria e kurseve nga ofruesit e trajnimit.
- IV. Trajnimet e organizuara nga Instituti i Kosovës për Administratë Publike (IKAP) dhe Ministria e Financave për trajnimet e natyrës administrative dhe financiare.

### 4.3.3 Asetet

#### 4.3.3.1 Asetet në Posedim të Institucionit

ASHMDHP posedon pasuri jofinanciare, e cila është blerë për nevoja pune nga fundi i vitit 2011, donacioneve të pranuara nga Ambasada Norvegjeze, EULEX, dhe Komisioni Evropian (Projekti IPA). Pasuria është e ndarë në dy përmbledhje:

1. Përmbledhja e pasurive jofinanciare me vlerë nën €1000 dhe me afat përdorimi më shumë se një vit, gjithsej 275 artikuj me vlerë të blerjes **€81.987,47** dhe vlera e tanishme (31.12.2018) pas amortizimit prej **€10.868,84**. ASHMDHP ka pajisjet e nevojshme për punë për numrin momental të zyrtarëve (kompjuterë, printerë, llap-topë, tavolina pune, ormanë, etj);
2. Përmbledhja e pasurive jofinanciare kapitale (me vlerë mbi €1000) në posedim të organizatës buxhetore, gjithsej 36 artikuj me vlerë të blerjes **€164.032,67** dhe vlera e tanishme e pasurisë kapitale pas amortizimit ndër vite në vlerë prej **€39.486,76**.

Vlerat e lartcekura janë prerje në fund të vitit kalendarik dhe financiar 2018, dmth. deri më datën 31.12.2018.



Tabela 3 – Lista e Pasurisë Kapitale në vlerë mbi €1000

Nr.	Emri	Data e blerjes/ donacion	Sasia
1	KIA RIO	19/07/2012	1
2	KIA CEED	19/07/2012	1
3	Digital Sender Flatbed, ADF	26/12/2013	2
4	Dell Poweredge R515, Server RACK	26/12/2013	2
5	Sonic Wall NSA 2400	26/12/2013	1
6	Dell Rack 2420	26/12/2013	1
7	Dell Rack UPS	26/12/2013	1
8	HDD Statin- Fantec 8*4TB	26/12/2013	1
9	Digitall Camera Canon EOS 600D	26/12/2013	1
10	Fotocopy Digital MFP Canon IRC3580NE	26/12/2013	1
11	Notebook	27/01/2014	4
12	Peugeot 3008	27/11/2014	1
13	Peugeot 301	24/12/2014	2
14	Nissan Patrol	21/07/2015	2
15	HP liteboock 840 G1 Notebook PC	27/10/2015	9
16	Printer color HP laserjet enterprise M552	27/10/2015	2
17	Konica Minolta	27/10/2015	1
18	HP LTO5 Ultrium 3000 SAS Ext tape drive	27/10/2015	1
19	16 GB 1600 Mhz DDR3 Dual Rank RDIMM Memory module	27/10/2015	2
			<b>36</b>

#### 4.3.3.2 Planet për Asete të Reja

ASHMDHP është e vendosur në objekt shtetëror dhe objekti ku është e vendosur agjencia gjendet në oborrin prapa Ministrisë së Punëve të Jashtme, gjegjësisht aneksi i objektit të ish APJ-së. Në fund të vitit 2015, nga Ministria e Administratës Publike kemi pranuar hapësira shtesë me lirim të një aneksi nga EULEX-i, të cilat hapësira janë renovuar dhe përshtatur në hapësira për punë (zyra), dhe Agjencia ka vendosur pajisjet e nevojshme për punë (kompjuterë, printerë, tavolina pune, ormanë, etj). Në bazë të kërkesave të vazhdueshme për plotësim të personelit parashikohet të lindë nevoja për blerje të reja të pasiveve për punë dhe shtimin e hapësirave të punës.

## 5 Aktivitetet e Agjencisë në Fushën e Mbrojtjes së të Dhënave Personale

### 5.1 Këshilla dhe Opinione

Agjencia ka dhënë këshilla dhe opinione institucioneve publike dhe private për të gjitha çështjet lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale, duke përfshirë edhe interpretimin dhe zbatimin e ligjit dhe të gjitha ligjeve dhe rregulloreve që parashohin përpunimin e të dhënave personale.

## 5.2 Këshillat e Agjencisë

Në kuadër të përgjegjësisë, Agjencia, gjatë këtij viti, ka dhënë 87 këshilla institucioneve të ndryshme lidhur me zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Agjencia i është përgjigjur një numri të madh të pyetjeve të ardhura nga mediumet, shoqëria civile, kontrolluesit (publikë dhe privatë) dhe qytetarët, lidhur me çështjet e ndryshme të ngritura për mbrojtjen e të dhënave personale.




Figura 2 – Këshillat e dhëna ndër vite

Agjencia, në vazhdimësi ka dhënë këshilla të ndryshme gjatë takimeve me zyrtarë përgjegjës të mbrojtjes së të dhënave personale në institucione publiko – private.

## 5.3 Konsultim me Rastin e Hartimit të Masave Legjislative dhe Administrative

Në bazë të nenit 39 të Ligjit 03/L-172 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, ku thuhet se Kuvendi i Kosovës dhe Qeveria e Kosovës duhet ta informojnë Agjencinë me rastin e hartimit të masave legjislative dhe administrative që kanë të bëjnë me përpunimin e të dhënave personale, Agjencia, gjatë vitit 2018, ka shqyrtuar dhe ka dhënë mendimet e saj lidhur me ligjet dhe aktet tjera nënligjore që kanë ardhur për konsultim në Agjenci edhe atë: për 27 projektligje, 13 draft-rregullore, 47 udhëzime administrative si dhe 19 akte të tjera, përfshirë këtu memorandume shpjeguese, draft-marrëveshje, memorandume mirëkuptimi, koncept dokumente si dhe akte tjera administrative.



## Konsultimet rreth Hartimit të Masave Legjislative dhe Administrative ndër vite




Figura 3 – Konsultimet rreth Hartimit të Masave Legjislative dhe Administrative ndër vite

Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka shqyrtuar dhe ka dhënë mendimin për këto akte:

### PROJEKTLIGJE

1. Projektligjin për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale të Republikës së Kosovës;
2. Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Financimin e Subjekteve Politike;
3. Projektligjin për të Drejtën Ndërkombëtare Private;
4. Projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 05/1-010 për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës;
5. Projektligjin për Arsimin e Lartë;
6. Projektligjin për Mbrojtjen e Sinjalizuesve;
7. Projektligjin për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit;
8. Projektligjin për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura;
9. Projektligjin për Zyrtarët Publikë në Republikën e Kosovës;
10. Projektligjin për Pagat;



11. Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.04/L-008 për Këshillin Ekonomiko-Social;
12. Projektligjin për Kompetencat e Zgjeruara të Konfiskimit të Pasurisë;
13. Projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 05/L-010 për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës;
14. Projektligjin për Ndërmarrjet Publike;
15. Projektligjin për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave;
16. Projektligjin për Tatimin në të Ardhurat Personale;
17. Projektligjin për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar;
18. Projektligjin për Pensionet e Zyrtarëve Policorë të Policisë së Kosovës dhe Punonjësit e Inspektoratit Policor të Kosovës me Autorizime Policore;
19. Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-174 për Financimin e Subjekteve Politike të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-058;
20. Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhje të Përgjithshme në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 03/L-256;
21. Projektligjin për Mbrojtjen e Informacionit të Klasifikuar;
22. Projektligjin nr. XX për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.04/L-061 për Shitjen e Banesave për të cilat ekziston e drejta banesore, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.04/L-247;
23. Projektligjin për Tokën Ndërtimore;
24. Projektligjin për Avokaturën Shtetërore;
25. Projektligjin për Tekste Shkollore, Mjetet dhe Materialet Mësimore, Lekturën Shkollore dhe Dokumentacionin Pedagogjik në Arsimin Parauniversitar;
26. Projektligjin për Administratën Tatimore dhe Procedurat;
27. Projektligjin për Konfliktet Administrative.

## PROJEKT RREGULLORE

1. Projekt Rregulloren për Punën e Bordit Këshillëdhënës të Agjencisë së Punësimit;
2. Projekt Rregulloren Teknike (MTI) Nr. Xx/2018 për Pajisjet Elektrike të Dizajnuara për Përdorim Brenda Kufijve të Caktuar të Tensionit;
3. Projekt Rregulloren e Zhvillimit të Karrierës së Pjesëtarëve të FSK-së;
4. Projekt Rregulloren për Procedurat dhe Format e Njoftimit për Ndihmën Shtetërore;
5. Projekt Rregulloren (QRK) nr. Xx2018 për Sistemin e Integruar Informativ për Zhvillim Ekonomik të Kosovës;
6. Projekt Rregulloren për Komisionin Kombëtar për Refugjatë;
7. Projekt Rregulloren QRK-nr. xx/ \_\_\_\_\_ për Procedurat e Emërimit në Pozita të Larta Drejtuese në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës;



8. Projekt Rregulloren (QRK) - nr. Xxx/2018 për Mënyrën e Notifikimit dhe Ofrimit të Informacioneve mbi Rregulloret Teknike, Procedurat për Vlerësimin e Konformitetit dhe Standardet;
9. Projekt Rregulloren (MZHE) Nr.../2019 për Formën e Raportit të Aksidenteve në Punë në Miniera;
10. Projekt Rregulloren MF-Nr.xx / 2018 për Përfundimin e Vitit Fiskal;
11. Projekt Rregulloren MF- Nr. 00/2018 për Përdorim të Kartelës Kreditore për Udhëtime Zyrtare;
12. Projekt Rregulloren QRK - Nr. 00/2018 për Themelimin dhe Zbatimin e Funkcionit të Auditimit të Brendshëm në Subjektin e Sektorit Publik;
13. Projekt Rregulloren për Funksonimin e Qendrës për Azil.

## PROJEKT UDHËZIME ADMINISTRATIVE

1. Udhëzimin Administrativ për Shtypjen e Numrit VIN të Automjeteve;
2. Udhëzimin Administrativ për Gradat e Zyrtarëve Korrektues, Kontrollimi i së Kaluarës së Tyre, Periudha Provuese dhe Promovimi;
3. Udhëzimin Administrativ (MI) Nr. Xx/2017 për Ndryshim dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ nr.13/2017 për Plan Programin për Aftësimin e Kandidatëve për Shoferë;
4. Udhëzimin Administrativ (MI) Nr. Xx/2017 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ nr.21/2017 për Mbatjen e Trajnimeve dhe Seminareve në Fushën e Patentë Shoferit;
5. Udhëzimin Administrativ (MI) Nr. Xx/2018 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ nr.08/2016 për Pyetës;
6. Udhëzimin Administrativ (MI) Nr. XX/2017 për Udhëzim Administrativ (MI) Nr xx/2018 për Funksonimin, Mënyren e Organizimit dhe Financimin e Këshillit për Siguri në Trafikun Rrugor;
7. Udhëzimin Administrativ (MI) Nr. XX/2018 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 11/2017 për Trajnerë në Fushën e Patentë Shoferit;
8. Udhëzimin Administrativ për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ nr.15/2017 për Ligjërues Profesional në Auto Shkollë;
9. Udhëzimin Administrativ (MI) nr. Xx/2017 për Organizimin e Provimit për Certifikatën e Kualifikimit Profesional;
10. Udhëzimin Administrativ (MPB) nr. 00 /2018 për Procedurat për Pajisje me Letërnjoftim;
11. Udhëzimin Administrativ për Plotësim Ndryshimin e Udhëzimit Administrativ nr.05/2017 për Shkollim Specialistik;
12. Udhëzimin Administrativ (MI) nr. Xxx/18 për Kontrollimin e Rregullsisë Teknike të Automjeteve në Rrugë;



13. Udhëzimin Administrativ për Përmbajtjen dhe Mënyrën e Dhënies së Provimit Profesional për Mbikëqyrësit e Zonave të Mbrojtura;
14. Udhëzimin Administrativ për Rregullimin e Çmimit të Produkteve dhe Pajisjeve Medicinale;
15. Udhëzimin Administrativ (MI) Nr. XX/2018 për Vendosjen e Panove Reklamuese në Autoudhë, Rrugë Nacionale dhe Rajonale;
16. Udhëzimin Administrativ për Stabilimentet dhe Pajisjet për Automjetet Motorike me Gaz;
17. Udhëzimin Administrativ (MTI) Nr. 00/2018 për Mënyrën e Emërimit të Trupave për Vlerësim të Konformitetit;
18. Udhëzimin Administrativ për Përcaktimin e Procedurave për Përgatitjen dhe Shqyrtimin e Kërkesave për Kushte Ndërtimore, Leje Ndërtimore dhe Leje Rrërimi për Kategorinë e III-të të Ndërtimeve;
19. Udhëzimin Administrativ për Vërejtjet e Kombinuara;
20. Udhëzimin Administrativ për Legalizimin e Armëve të Kategorisë B, C dhe D;
21. Udhëzimin Administrativ (MPB) Nr. 00/2018 për Normat Teknike për Mbrojtjen e Depove nga Zjarri dhe Shpërthimet;
22. Udhëzimin Administrativ Nr.../2018 për Kushtet dhe Procedurat e Veçanta për Dhënien e Lejes për të Dënuarit që të Punojnë Jashtë Institucionit Korrektues;
23. Udhëzimin Administrativ MF- nr. xx/2018 për Vlerësimin e Rrezikut Kombëtar për Pastrimin e Parave dhe Financimin e Terrorizmit;
24. Udhëzimin Administrativ MD-nr. \_\_\_/2018 për Procedurën për Punësimin e të Dënuarve, Pezullimin dhe Lirimin e të Dënuarve nga Puna;
25. Udhëzimin Administrativ për Mjetet me Vlerë Muzeore;
26. Udhëzimin Administrativ për Përcaktimin e Simboleve për Treguesit Gjeografikë, Emërtimit të Origjinës dhe Specialitetit Tradicional të Garantuar;
27. Udhëzimin Administrativ për Eksport, Import ose Kalimin Tranzit të Mbeturinave;
28. Udhëzimin Administrativ (QRK-së) për Kufizimin e Emisioneve të Ndotësve në Ajër nga Burimet e Palëvizshme të Ndotjes;
29. Udhëzimin Administrativ (MTI) Nr.00/2018 për Procedurën e Trajtimit të Ankesave nga Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorit;
30. Udhëzimin Administrativ (MTI) Nr. 00/2018 për Caktimin e Formës, Përmbajtjes dhe Përdorimit të Logos së Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorit;
31. Udhëzimin Administrativ Nr. 00/2018 për Kërkesat Teknike dhe Metrologjike për Transformatorët Matës të Grupeve Matëse për Matjen e Energjisë Elektrike;
32. Udhëzimin Administrativ (MI) Nr. Xx/2018 për Hetimin e Aksidenteve dhe Incidenteve në Transportin Hekurudhor;
33. Udhëzimin Administrativ nr. 00/2018 për Emërimin e Trupave për Vlerësimin e Konformitetit të Mjeteve Matëse të Rrjedhjes së Lëngjeve me Përjashtim të Ujit;
34. Udhëzimin Administrativ (MPB) Nr. xx/2018 për Kushtet dhe Procedurat e Dhënies së Provimit Profesional për Zyrtarë të Gjendjes Civile;



35. Udhëzimin Administrativ për Kushtet dhe Procedurat për Ushtrimin e Veprimtarisë Shëndetësore në Institucionet Private;
36. Udhëzimin Administrativ (MPB) Nr. Xx/2018 për Përdorimin e Kopjeve të Certifikuara të Regjistrave Originalë Themeltarë të Gjendjes Civile të Kosovës, të cilat janë marrë nga ish-pushteti serb, para qershorit të vitit 1999;
37. Udhëzimin Administrativ (MPB) Nr. 00/2018 për Trajnimin Fillestar në Fushën e Mbrojtjes nga Zjarri;
38. Udhëzimin Administrativ (MPB) për Pajisje me Letërnjoftim, Pasaportë dhe Patentë Shoferë me Procedurë të Përsheptuar;
39. Udhëzimin Administrativ mbi Formularin për Informacionin, Kohën dhe Procedurat e Zbatimit të Tërheqjes nga Kontratat në Distançë dhe Jashtë Objektivit Afarist;
40. Udhëzimin Administrativ për Procedurat e Ankimit;
41. Udhëzimin Administrativ (MPB) Nr. 00/2018 për Vulën Verifikuese;
42. Udhëzimin Administrativ për Përmbajtjen e Formularit të Kërkesës dhe Njoftimit për Fillimin e Hetimeve për Masa Mbrojtëse në Importe;
43. Udhëzimin Administrativ MF -NR.00/2018 për Themelimin dhe Funkcionimin e Komitetit të Auditimit në Subjektin e Sektorit Publik;
44. Udhëzimin Administrativ për Caktimin e Formës, Përmbajtjes dhe Përdorimit të Flamurit mbi Origjinën e Produktit;
45. Udhëzimin Administrativ MF - Nr. XX/2018 për Kriteret Përzgjedhëse dhe Prioritetizimin e Projektit Kapital;
46. Udhëzimin Administrativ për të Ushqyerit e Shëndetshëm në Institucionet e Arsimit Parauniversitar;
47. Udhëzimin Administrativ Nr.XX/2018 për Caktimin e Kërkesave, Kushteve dhe Procedurat e Krijimit të Numrit Unik Identifikues.

## DOKUMENTE TË TJERA

1. Projekt Strategjia Shtetërore Kundër Krimit të Organizuar dhe Plani i Veprimit 2018 – 2022;
2. Koncept dokumenti për Statusin e Forcave të Huaja të Armatosura në Territorin e Republikës së Kosovës;
3. Koncept dokumentin për Borxhin Publik;
4. Koncept dokumentin për Procedurën Kontestimore;
5. Koncept dokumentin për Fushëveprimin e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme;
6. Koncept dokumentin për Letërnjoftimin;
7. Programin e Zbatimit të Strategjisë së Energjisë 2018-2020;
8. Koncept dokumentin për Rendin dhe Qetësinë Publike;
9. Koncept dokumentin për Tubime Publike;



10. Koncept dokumenti për Fushën e Bashkëpunimit Juridik Ndërkombëtar në Çështje Penale;
11. Koncept dokumentin për Valën e Parë të Racionalizimit dhe Vendosijes së Vijave të Llogaridhënies për Agjencitë të cilat funksionojnë në Kuvendin e Kosovës;
12. Koncept dokumenti për Ndryshimin e Politikave Fiskale dhe Bujqësore për Prodhimin e Duhanit dhe Cigareve në Kosovë;
13. Koncept dokumentin për Financat e Pushtetit Lokal;
14. Shtojca për Formën e Raportit të Aksidenteve në Punë në Miniera;
15. Koncept dokument për Rregullimin e Fushës së Hetimit të Aksidenteve dhe Incidenteve për Aviacionin Civil dhe Hekurudhat;
16. Koncept dokumentin për Masat e Sigurisë së Rrjeteve dhe Sistemeve të Informacionit;
17. Drafti i Strategjisë së Politikës së Jashtme;
18. Koncept dokumentit për Fushën e Konkurrencës.

## 5.4 Ankesat

Sipas Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, çdo person i cili konsideron se i është shkelur e drejta e tij/saj në privatësi në kuptim të të dhënave personale, mund të parashtrojë ankesë në Agjenci.

Ankesat janë parashtruar gojarisht, përmes telefonit, me shkrim dhe përmes mjeteve tjera të komunikimit elektronik. Agjencia, po ashtu, ka mundur që formulari për ankesë të shkarkohet nga ueb-faqja zyrtare. Agjencia, gjatë vitit 2018 ka pranuar gjithsej 42 ankesa.

Qytetarët e Republikës së Kosovës kanë ngritur shqetësimet e tyre kryesisht për përpunimin e të dhënave personale nga ana e kontrolluesve, me ç'rast të dhënat e tyre janë përpunuar me qëllim të marketingut të drejtpërdrejtë, zbulim të paautorizuar të të dhënave, zbulim i paautorizuar i të dhënave personale të ndjeshme, përpunimin e të dhënave biometrike, përpunimi i të dhënave pa pëlqimin e subjektit, përpunimin e të dhënave personale përmes rrjeteve sociale si dhe përpunimi i të dhënave jo të sakta. Këto ankesa kanë qenë kryesisht të orientuara ndaj institucioneve qendrore, institucioneve lokale, sektorit bankar, sektorit mikrofinanciar, kompanive të sigurimeve, sektorit shëndetësor, qendrave tregtare, rrjeteve sociale.

Numri i ankesave është tregues se qytetarët e Republikës së Kosovës kanë njohuri gjithnjë e më shumë në lidhje me të drejtat e tyre të garantuara me ligj. Me qëllim të ndërgjegjësimit të qytetarëve në lidhje me të drejtat e tyre, Agjencia do të vazhdojë me fushatat ndërgjegjëse edhe në vitet e ardhshme.




Figura 4 – Ankesat e shqyrtuara ndër vite

## 5.5 Inspektimi dhe Kontrolli

Agjencia bën mbikëqyrjen e legjitimitetit të përpunimit të të dhënave personale, i cili realizohet përmes inspektimeve dhe kontrolleve.

Agjencia ka kompletuar tërë kornizën e nevojshme për realizimin e inspektimeve dhe kontrolleve. Në kuadër të kësaj, Agjencia ka nxjerrë Rregulloren për Inspektim, Listën e Kontrollit dhe Formularin e Procesverbalit. Agjencia, gjatë vitit 2018 është në kuadër të ndryshimeve ligjore, për mbrojtjen e të dhënave personale dhe në mënyrë të vazhdueshme, në bashkëpunim me Zyrën e Kryeministrit, ka organizuar grupe punuese për finalizimin e draftimit të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale. Si shkak i ndryshimeve ligjore, Agjencia nuk ka realizuar inspektime, duke pasur parasysh që me ndryshimet ligjore inspektimet dhe kontrollet do të realizohen nga shërbyesit civilë brenda institucionit.

Agjencia, gjatë vitit 2018, ka pranuar gjithsej 42 ankesa, duke pasur parasysh që ky autoritet i është nënshtruar ndryshimeve ligjore, disa nga ankesa janë trajtuar pasi që ka pasur ankesa të natyrave të tilla dhe ne kemi rekomanduar organet publiko – private që përpunimi i të dhënave personale të jetë në harmoni me Ligjin Nr.03/L-172 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

### 5.5.1 Përpunimi i të Dhënave Biometrike

Në bazë të Ligjit për Mbrojtjen të Dhënave Personale, të dhënat biometrike konsiderohen të dhëna personale të ndjeshme dhe si të tilla ato duhet të mbrohen në mënyrë të veçantë dhe të klasifikohen me qëllim të parandalimit të qasjes dhe përdorimit të paautorizuar.

Sektori publik dhe privat mund ti përdorë karakteristikat biometrike vetëm nëse është e domosdoshme për sigurinë e njerëzve, sigurimin e pronës ose mbrojtjen e të dhënave konfidenciale dhe sekreteve të biznesit.



Në bazë të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, vlerësimin e domosdoshmërisë së përdorimit të të dhënave biometrike e bën Agjencia, përmes dhënies së autorizimit për përdorim, përveç rasteve të parapara me ligj.

Të gjitha organet publike dhe private të cilat dëshirojnë të përpunojnë të dhënat biometrike, përveç rasteve të parapara me ligj, para përdorimit të të dhënave biometrike duhet marrë autorizimin nga Agjencia në harmoni me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Në vitin 2018 Agjencia nuk ka pranuar asnjë kërkesë për marrjen e autorizimit për përdorimin e karakteristikave biometrike.

## 5.5.2 Transferimi i të Dhënave Personale

Në harmoni me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, transferimi i të dhënave personale, të cilat janë përpunuar ose ato që do të përpunohen në vende të tjera apo në organizata ndërkombëtare, mund të bëhet vetëm nëse këto vende sigurojnë nivel të duhur të mbrojtjes së të dhënave. Për të gjitha ato vende apo organizata ndërkombëtare të cilat nuk sigurojnë nivelin e duhur të mbrojtjes së të dhënave, organi publik apo privat që dëshiron të bëjë transferim të të dhënave, duhet të ndjekë procedurat e marrjes së autorizimit nga Agjencia.

Agjencia ka të aprovuar legjislacionin sekondar me të cilin rregullohen procedurat e transferimit të të dhënave personale jashtë vendit. Në kuadër të këtij legjislacioni sekondar, Agjencia ka të aprovuar Rregulloren mbi Procedurat e Brendshme të Shqyrtimit të Kërkesave për Lejimin e Transferimit Ndërkombëtar të të Dhënave Personale, si dhe formularin i cili duhet të plotësohet me rastin e kërkesës nga ana e institucionit për transferimin e të dhënave.

Me qëllim të përmbushjes së obligimit ligjor si dhe për të kontribuar në krijimin e lehtësive për transferimin e të dhënave, Agjencia, përmes një vendimi formal, ka aprovuar listën e vendeve dhe organizatave ndërkombëtare që sigurojnë nivel të duhur të mbrojtjes së të dhënave personale dhe për të njëjtat vende nuk kërkohet marrje e autorizimit nga ana e Agjencisë.

Lista e vendeve dhe organizatave ndërkombëtare të cilat sigurojnë nivel të duhur të mbrojtjes së të dhënave personale përmban shtetet si më poshtë:

- Austri
- Belgjikë
- Bullgari
- Kroaci
- Qipro
- RepublikëÇeke
- Danimarkë
- Estoni
- Finlandë
- Francë
- Gjermani
- Greqi
- Hungari
- Irlandë
- Itali
- Letoni
- Lituani
- Luksemburg
- Maltë
- Holandë
- Poloni
- Portugali
- Rumani
- Sllovaki
- Slloveni
- Spanjë
- Suedi
- Britani e Madhe
- Izrael
- Uruguaj

Shtetet anëtare të “Zonës Ekonomike Evropiane” konkretisht listohen:





- Islandë
- Lihtenshtajn
- Norvegji
- Zvicër

Në mbështetje të nenit 53 (paragrafi 2) “Agjencia mund të zbatojë vendimet e marra nga organi kompetent i Bashkimit Evropian nëse vendet e tilla dhe organizatat ndërkombëtare sigurojnë nivel të duhur të mbrojtjes së të dhënave”, ku Komisioni Evropian deri më tani ka marrë këto vendime mbi përshtatshmërinë e mbrojtjes së të dhënave personale në vendet e treta:

- Argjentinë
- Australi
- Andorë
- Kanadë
- Guernsey
- Ishulli i Manit
- Jersey
- Ishujt Faroe
- Zelanda e Re

Në harmoni me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Agjencia ka publikuar listën e vendeve dhe organizatave ndërkombëtare që sigurojnë nivel të duhur të mbrojtjes së të dhënave personale në Gazetën Zyrtare dhe në faqen publike të Agjencisë.

## 5.6 Informimi dhe Promovimi

Në kuadër të planit vjetor të punës, Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, edhe gjatë vitit 2018, rëndësi të posaçme ka vazhduar t’i kushtojë komunikimit me publikun. Në këtë kuadër, të gjitha mediumet e shkruara dhe elektronike vendore kanë qenë të informuara me kohë për çdo aktivitet të planifikuar dhe të realizuar nga Agjencia, duke shfrytëzuar për këtë web faqen e Agjencisë, faqen zyrtare të saj në *Facebook* dhe *Twitter*, si dhe kontaktet e drejtpërdrejta me medime. Veç kësaj, po në këtë ditë, me nismën e Agjencisë, arsimtarët e të gjitha shkollave të mesme të Komunës së Prishtinës mbajtën një ligjeratë rreth rëndësisë së privatësisë. Për këtë, Agjencia edhe këtë vit, siç është bërë traditë tashmë, u kishte shpërndarë paraprakisht një udhëzues të posaçëm në formë planprogrami për ta lehtësuar këtë ligjeratë.

Si çdo janar, në emër të Agjencisë është publikuar, në shumë gazeta e portale, një artikull gazetaresk në formë editoriali me titull “Privatësia – nga një e Drejtë në Traditë”. Qëllimi i këtij publikimi tradicional, i cili bëhet të paktën dy herë në vit, respektivisht çdo 28 janar dhe 30 qershor, si data specifike për autoritetin tonë, ka qenë që qytetarët të informohen më shumë rreth autoritetit të mandatuar për të mbrojtur të drejtën e tyre në privatësi, si dhe të njohtohen më hollësisht rreth historikur të 28 Janarit – Ditës Ndërkombëtare të Privatësisë.

Organizimi tradicional për nder të Ditës Ndërkombëtare të Privatësisë, u karakterizua edhe me të ftuar nga autoriteti homolog i Shqipërisë, si dhe përfaqësues të sektorit të shëndetësisë të vendit tonë, në bashkërendim me të cilët, ky vit u shpall si vit i fokusit të Agjencisë ndaj shëndetësisë. Me këtë rast, janë shpërndarë dy udhëzues për këtë sektor, njëri i dedikuar për kompanitë që ofrojnë sigurime shëndetësore dhe tjetri për institucionet e kujdesit shëndetësor, të cilët ofrojnë informata bazike për përpunimin e ligjshëm të të dhënave personale nga të punësuarit brenda këtij sektori.



Foto 1. Pamje nga konferenca e organizuar me rastin e Ditës Evropiane të Mbrojtjes së të Dhënave.

Vlenë të theksohet se gjatë javës së fundit të janarit, gjatë dhe pas shënimit të Ditës Evropiane të Mbrojtjes së të Dhënave, Drejtori i Departamentit për Marrëdhënie me Jashtë është ftuar nga televizionet publike dhe disa radio, si mysafirë, për të folur rreth rëndësisë së privatësisë së qytetarëve, me theks të veçantë rreth zhvillimeve të reja brenda këtij autoriteti për sa u përket ndryshimeve ligjore dhe kompetencave të reja të tij.

Gjatë vitit 2018, në kuadër të planit të punës, janë realizuar të gjitha fushatat e karakterit informues, vetëdijesues dhe ndërgjegjësues, të dedikuara kryesisht për sektorin e shëndetësisë, siç ishte shpallur më 28 janar.

Gjithashtu, gjatë këtij viti, Agjencia ka marrë pjesë në forume të ndryshme, të cilat i ka shfrytëzuar për vetëdijesimin e qytetarëve në këtë fushë.

Për më tepër, zyra për komunikim me publikun në kuadër të Departamentit të Regjistrimit dhe Marrëdhënieve me Jashtë, në vazhdimësi ka mbajtur komunikimin me qytetarë, e në veçanti me komunitetin e gazetarisë, duke u kthyer përgjigje ndaj pyetjeve të tyre, kërkesave për intervista, kërkesave për qasje në dokumente publike, e kështu me radhë.

Në sajë të aktiviteteve të saj promovuese, Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, gjatë muajit korrik lancoi 'Alfabetin e të Dhënave Personale', të parin e këtij lloji. Qëllimi i këtij fjalorthi terminologjik ishte që t'u shërbejë qytetarëve që të bëhen më të kujdesshëm në publikimin e të dhënave të tyre.

Ky 'alfabet' i është vënë në dispozicion publikut në trajtën e një videoje dhe një albumi fotografik, me përmbajtje të njëjtë dhe si i tillë u është shpërndarë përdoruesve të rrjeteve sociale (kryesisht në Facebook) brenda territorit Kosovës.

Përgjatë muajit korrik, me kërkesë të rektoratit të UP 'Hasan Prishtina, z. Jeton Arifi, drejtor në Agjenci, ka ligjeruar lidhur me çështjen e privatësisë për studentët vendorë dhe ndërkombëtarë, të cilët kanë ndjekur ligjeratat në sajë të universitetit veror.

Me kërkesën e Ministrisë së Jashtme dhe sipas ankesave të pranuar në Agjenci, zyrtarë të ASHMDHP-së, gjatë mesit të korrikut, kanë zhvilluar një vizitë të karakterit këshillues në Ambasadën e RKS në Zvicër dhe zyrat konsullore në Bern dhe Zürich. Me këtë rast, diplomatëve të angazhuar në këtë mision dhe stafit ndihmës i janë dhënë këshilla dhe rekomandime lidhur me masat e sigurisë gjatë përpunimit të të dhënave personale të bashkatdhetarëve tanë në Zvicër.

Në periudhën tetor – nëntor, në kuadër të planit vjetor të punës për vitin 2018, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, Shkencës e Teknologjisë, është realizuar projekti ndërgjegjësues 'Trajnim rreth Përpunimit të të Dhënave Personale në Sektorin e Arsimit' lidhur me ligjshmërinë e përpunimit të të dhënave brenda sektorit të arsimit, me fokus në institucionet e arsimit të mesëm, gjegjësisht me nivelin akademik të sektorit të arsimitm respektivisht me drejtorët e sekretarët e shkollave të pesë komunave (Deçanit, Gjakovës, Drenasit, Gjilanit, Kamenicës).

Si vazhdimësi e aktiviteteve që Agjencia ka zhvilluar përgjatë vitit 2018, ndër objektivat kryesor kishte trajnimin dhe ndërgjegjësimin e punonjësve në sektorin e shëndetësisë. Në koordinim me zyrtaren për mbrojtjen e të dhënave personale të akredituar në SHSKUK, znj. Mirvete Latifaj, si dhe në cilësinë e ligjëruesve nga Agjencia, z. Jeton Arifi (drejtor në Agjenci) dhe Kushtrim Mustafa (koordinator i zyrës së inspektimit), u realizua projekti njëjavor që përfshiu shtatë spitale regjionale: atë të Prizrenit, Mitrovicës, Vushtrrisë, Gjilanit, Gjakovës dhe Pejës. Temat e diskutuara në këto punëtori kishin për qëllim, fillimisht njoftimin e punonjësve me dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, si dhe ndarjen e përvojave me rastet konkrete që kanë të bëjnë me përpunim e të dhënave të ndjeshme.



*Foto 2. Pamje nga fushata ndërgjegjësuese me sektorin e shëndetësisë në spitalin regional të Pejës.*

Me qëllim të ndërgjegjësimin të institucioneve publike dhe private mbi obligimet ligjore për mbrojtjen e të dhënave personale, Agjencia ka vazhduar gjatë gjithë vitit me organizim të seminareve ndërgjegjësuese dhe ka dhënë kontributin në të gjitha organizimeve që janë organizuar me temat në mbrojtjen e të dhënave personale.

Për të qenë sa më pranë publikut, Agjencia ka shfrytëzuar relacionet e krijuara me komunitetin e gazetarisë që me rastin e çdo ngjarjeje të veçantë të organizuar prej saj të ketë përfaqësuesit e saj të ftuar në cilësinë e mysafirëve në mediumet publike e private, si TV dhe radio, me qëllim të informimit sa më të mirë të publikut rreth çështjes së privatësisë dhe mbrojtjes së të dhënave personale.



Gjatë vitit 2018 me tema të ndryshme të mbrojtjes së të dhënave personale, janë bërë shtatë (7) publikime (lajme/njoftime) në web faqen zyrtare të Agjencisë dhe në llogarinë zyrtare të saj në *Facebook*, të cilat kanë pasur për qëllim njoftimin e publikut rreth aktiviteteve të përgjithshme të këtij autoriteti si dhe informimin e qytetarëve për risitë në vend dhe nga bota lidhur me çështjet e privatësisë. Shkrimet e karakterit njoftues janë publikuar kryesisht në ueb faqen zyrtare të Agjencisë, por nuk kanë munguar edhe shkrimet e publikuara në portalet elektronike dhe gazetatat ditore, varësisht nga ngjarjet që ka organizuar apo në të cilat është përfaqësuar Agjencia.

## 5.7 Bashkëpunimi Vendor dhe Ndërkombëtar

Raportet bashkëpunuese të këtij viti kanë filluar me nismën për të angazhuar një ekspert slloven me përvojë në autoritetin homolog të këtij vendi anëtar të BE-së për të na asistuar në hartimin e dy projekt ligjeve të reja, atij për mbrojtjen e të dhënave personale dhe projekt ligjit për qasjen në dokumente publike. I njëjti ekspert është angazhuar përmes instrumentit TAIEEX, për të cilin është aplikuar dhe arritur nga Agjencia përmes arsyetimit të paraqitur në Zyrën e BE-së në Kosovë.

Gjatë muajit shkurt, në saje të bashkëpunimit ndërinstitucional vendor, Agjencia ka organizuar një grup punes për vazhdimin e punimeve rreth hartimit të projektligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, ku, përveç përfaqësuesve nga Institucioni i Avokatit të Popullit, Ministrisë së Administratës Publike, Zyrës së Kryeministrit, organizatave joqeveritare, kanë marrë pjesë edhe ekspertë të fushës nga Zyra e BE-së në Prishtinë.

Ky grup punues i ka zhvilluar punimet në Tiranë, me ç'rast është zhvilluar edhe një vizitë pranë autoritetit homolog të Shqipërisë për të parë funksionimin e mbikëqyrjes së zbatimit të dy ligjeve përkatëse nga i njëjti autoritet.

Në kuadër të programit për trajnim fillestar të gjyqtarëve të rinj, me kërkesë të Akademisë së Drejtësisë, Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, më 27 mars 2018, ka zhvilluar trajnim njëditor për dyzet e nëntë gjyqtarë.

Temat rreth të cilave kanë ligjeruar z. Bujar Sadiku, Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë dhe z. Kushtrim Mustafa, Koordinator i Zyrës së Inspektimit, ishin të përqendruara kryesisht rreth historikut dhe strukturës organizative të ASHMDHP-së, pastaj mbi përkufizimin, parimet dhe fushëveprimin e saj të përgjithshëm, e në veçanti rreth rasteve konkrete, të cilat i ka zgjidhur kjo Agjenci.

Në javën e dytë të muajit prill, me ftesë të Grupit të Berlinit, tre përfaqësues të Agjencisë kanë marrë pjesë në punimet e takimit të 63-të grupit punues ndërkombëtar rreth përpunimit të të dhënave në fushën e telekomunikimit, që këtë radhë u mbajt në Budapest të Hungarisë. Autoriteti ynë, gjatë punimeve, ka raportuar në emër të shtetit lidhur me zhvillimet që prekin këtë fushë.

Duke e pasur si objektiv prioritar shtrirjen e bashkëpunimit me autoritetet homologe rajonale dhe ndërkombëtare, si dhe me organizatat evropiane e ndërkombëtare të cilat merren me promovimin e të drejtës së privatësisë, Agjencia ka qenë aktive, duke u prezentuar në të gjitha forumet në të cilat ka status të definuar, si dhe në punëtoritë me tema të ndërlidhura me mbrojtjen e të dhënave personale. Me këtë rast, vlenë të theksohet pjesëmarrja e përfaqësuesve të Agjencisë në Forumin 'Iniciativa 20i7' gjatë gjysmës së dytë të muajit prill, të organizuar nga autoriteti homolog i Maqedonisë. Në këtë konferencë, në të cilën, pjesëmarrëse kanë qenë të gjitha autoritetet homologe të vendeve të ish

Jugosllavisë, Agjencia ka mbajtur një prezentim në gjuhën shqipe lidhur me temën ‘Përfshirja e GDPR brenda Legjislacionit Vendor për Mbrojtjen e të Dhënave – Sfidat dhe Përparësitë’.

Me ftesë të autoritetit homolog të Shqipërisë, i cili, gjatë vitit raportues ka organizuar Konferencën Pranverore të Autoriteteve Evropiane për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Agjencia është përfaqësuar nga katër zyrtarë gjatë javës së parë të muajit maj në Tiranë.

Midis 13 dhe 14 qershor të këtij viti, me ftesë të autoritetit homolog izraelit, tre përfaqësues të Agjencisë kanë marrë pjesë në punimet e punëtorisë së organizuar në kuadër të GPEN (Rrjeti Global për Zbatimin e Privatësisë), ku, në emër të ASHMDHP-së ka prezantuar z. Jeton Arifi.



Foto 3. Pamje nga prezantimi i z. Jeton Arifi gjatë punimeve të konferencës së GPEN në Tel Aviv.

Në tetor të vitit raportues, me ftesë të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave të BE-së, dy përfaqësues të Agjencisë kanë marrë pjesë në punimet e Konferencës së Komisionerëve të Privatësisë të mbajtur në Bruksel.

Agjencia ka bashkëpunuar ngushtë me BE në Prishtinë, OSBE, shoqërinë civile, institucionet qendrore dhe lokale, institucionet e sigurisë dhe sundimit të ligjit duke qenë pjesë dhe duke kontribuar në aktivitete të përbashkëta në tryeza, punëtori dhe konferenca të ndryshme.

## 5.8 Bashkëpunimi me Zyrtarët e Mbrojtjes së të Dhënave

Aktivitetet bashkërenduese të zhvilluara përmes zyrtarit për mbrojtjen e të dhënave të akredituar nëpër institucionet publike e private janë dëshmuar shumë praktike dhe frutdhënëse. Gjatë përvojës shtatëvjeçare është konstatuar se të gjitha institucionet të cilat kanë caktuar ZMDH, jo vetëm që kanë treguar përkushtimin e respektimit të dispozitave ligjore për përcaktim të zyrtarit, por është vënë re dhe vullneti i tyre për bashkëpunimin e mëtutjeshëm në respektimin e Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Duke veçuar me këtë rast dhe angazhimin e madh të shumicës së ZMDH për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtës për mbrojtjen e të dhënave personale dhe të privatësisë, që jo rrallë ka rënë ndesh me politikat e organit të cilin e ka përfaqësuar.



Vlen të theksohet se gjatë periudhës njëvjeçare, DRMJ ka pranuar dy (2) vendime të reja për caktimin e zyrtarit për mbrojtjen e të dhënave personale. Me këtë mund të konstatohet se shumica e institucioneve publike qendrore dhe lokale kanë caktuar zyrтарin e brendshëm të mbrojtjes së të dhënave personale.

Ndër zyrтарët për mbrojtjen e të dhënave personale të akredituar nëpër institucionet publike më të përkushtuar në punën e tyre të karakterit ndërlidhës me Agjencinë, janë dëshmuar ata në sektorin e arsimit (ZMDHP në MASHT) dhe në sektorin e shëndetësisë (ZMDHP në SHSKUK).

## 5.9 Regjistrimi i Sistemit të Dosjeve

Agjencia, në bazë të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka themeluar dhe mbanë regjistër të sistemit të dosjeve.

Brenda vitit 2018, dy (2) kontrollues kanë sjellur dy (2) njoftime për regjistrimin e sistemit të dosjeve, nga kontrolluesit e sektorit privat dhe publik. Duke e pas parasysh se Ligji është në plotësim ndryshim dhe në mungesë të inspektimit dhe kontrollit, nuk ka pas njoftime për regjistrim nga të cilat janë gjeneruar të hyra.

## 6 Vlerësimet e Përgjithshme dhe Rekomandimet për Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Si rrjedhojë e zhvillimit të shpejtë të teknologjisë së informacionit, internetit, rrjeteve sociale, ngritjes së vetëdijes së qytetarëve, etj., mbrojtja e të dhënave personale po bëhet gjithnjë e më sfiduese.

Agjencia, gjatë vitit 2018, në kuadër të ndryshimeve ligjore për mbrojtjen e të dhënave personale, në mënyrë të vazhdueshme, në bashkëpunim me zyrën e Kryeministrit dhe akterë të tjerë institucionalë, ka mbajtur grupe punuese për hartimin e ligjit të ri për mbrojtjen e të dhënave personale.

Pas nje pune të vazhdueshme, ligji i ri për mbrojtjen e të dhënave, tashmë është miratuar dhe i njëjti ka hyrë në fuqi në afatin e përcaktuar.

Gjatë vitit 2018, Agjencia në mënyrë të vazhdueshme, ka pranuar ankesa, kërkesa për këshilla dhe opinione nga kontrolluesit publikë dhe privatë, kërkesa për konsultim sa i përket akteve ligjore dhe nënligjore të nxjerra nga institucionet që kanë të bëjnë me përpunimin e të dhënave personale.

Procesi i caktimit të zyrtarëve të brendshëm për mbrojtjen e të dhënave personale është pothuajse i përfunduar në organet publike qendrore dhe lokale. Pas trajnimeve të këtyre zyrtarëve është rritur bashkëpunimi në mes të Agjencisë dhe organeve publike dhe private, si rrjedhojë është rritur mundësia që Agjencia të jetë proaktive në parandalimin e shkeljeve të mundshme.

Me qëllim që Agjencia të jetë pjesë e nismave rajonale dhe ndërkombëtare, kemi të nënshkruara marrëveshje bashkëpunimi (9) me shumicën e vendeve të rajonit, si dhe me disa vende evropiane.

Jemi të anëtarësuar në shumë mekanizma rajonale dhe ndërkombëtarë, në disa si anëtare e përhershme dhe në disa si vëzhguese, e që vlenë të theksohet anëtarësimi në 'Grupin e Berlinit'.



Anëtarësimi dhe nënshkrimi i marrëveshjeve me vendet e rajonit dhe ato evropiane do të jetë prioritet i Agjencisë edhe në vitet e ardhshme.

Agjencia, për vitin 2018 ka aprovuar planin vjetor të punës dhe ka përcaktuar aktivitetet, të cilat janë zhvilluar sipas këtij plani, ku mund të themi se kemi arritur të realizojmë në masë të madhe planin e punës. Do të vazhdohet me fushatat sensibilizuese me qëllim të informimit të qytetarëve për të drejtat e tyre për mbrojtjen e të dhënave personale. Do të vazhdohet me ngritjen e kapaciteteve të zyrtarëve të Agjencisë përmes trajnimeve specifike dhe marrjes së përvojave, praktikave të vendeve tjera.

Ndryshimet e pritura legjislative tashmë janë arritur, me ç'rast pritet të ristrukturohet pjesa organizative e saj sipas ligjit të ri, do të mund të fuqizohet autoriteti përmes marrjes së kompetencave dhe autorizimeve shtesë ligjore siç janë këshillëdhënia për organet publike dhe private, marrja e vendimeve për ankesat e paraqitura, inspektimet dhe kontrollet, informimi i publikut, shqiptimi i masave ndëshkuese, bashkëpunimi me autoritete homologe evropiane, certifikimi i kontrolluesve, si dhe promovimi e përkrahja e të drejtave themelore për mbrojtjen e të dhënave personale janë pjesë e kompetencës të Agjencisë.

Është vazhduar me procesin e aplikimit për IPA 2 (projekti i binjakëzimit), janë ndjekur dhe plotësuar tre hapat e parë të aplikimit nga nëntë sosh. Ky projekt ka ngecje për shkak të miratimit të vonshëm të ligjit të ri dhe rrjedhimisht mos emërimit të Komisionerit të Agjencisë, si kriter që duhet të përmbushet për vazhdimin e këtij projekti.

Veç kësaj, Agjencia, gjatë periudhës raportuese, ka pranuar shumë kërkesa për të dhënë mendime që ndërliken me të dejeten e qasjes në dokumente publike. Bazuar në mandatin aktual që është mbikëqyrja e legjitimitetit të përpunimit të të dhënave personale, si dhe duke u nisur nga fakti që shumë autoriteteve homologe në rajon e më gjerë i është dhënë kompetencë shtesë ligjore mbikëqyrja për zbatimin e ligjit për qasje në dokumente publike si mandat shtesë. Në ligjin e ri për Ligjin për Qasje në Dokumente Publike është definuar kompetenca që Agjencia të mbikëqyrë edhe zbatimin e këtij ligji dhe presim që Kuvendi, brenda afatit procedural të miratojë këtë projektligj.

Mungesa e saktësisht të kategorive të të dhënave personale të nevojshme për përpunimin e të dhënave personale nga ana e kontrolluesve publikë dhe privatë është një ndër mungesat më të mëdha të legjislacionit në fuqi. Mungesa e këtij përcaktimi lë hapësirë që kontrolluesit publikë dhe privatë të mbledhin dhe grumbullojnë sasi të mëdha të të dhënave personale, që ato janë të panevojshme dhe në kundërshtim me parimet e përpunimit të të dhënave të përcaktuara me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Rekomandohet që të gjitha ligjet dhe aktet nënligjore, ku përcaktohet përpunimi i të dhënave personale, të përcaktohen qartë kategoritë e të dhënave që do të përpunohen me atë rast.

Përpos mungesës së kornizës ligjore të qartë, që përcakton kategoritë e të dhënave që mund të përpunohen, njëkohësisht në shumicën e rasteve mungon dhe koha e ruajtjes, ku si pasojë kemi grumbullimin dhe mbajtjen e të dhënave personale me vite të tëra, përkundër arritjes së qëllimit për të cilën fillimisht janë grumbulluar.

Rekomandohet në të gjitha ligjet dhe aktet nënligjore ku definohet përpunimi i të dhënave personale, të përcaktohen qartë afatet dhe procedurat e ruajtjes së të dhënave.



Mosratifikimi i Konventës 108 për Mbrojtjen e Individit me Rastin e Përpunimit Automatik të të Dhënave Personale, nga ana e Kuvendit të Kosovës e pamundëson Agjencinë që të anëtarësohet në organizmat evropiane në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale. Po ashtu, në mungesë të ratifikimit të kësaj konvente, Kosova nuk mund të jetë pjesë e listës së shteteve që sigurojnë nivel të duhur të mbrojtjes së të dhënave personale. Si rrjedhojë, transferimi i të dhënave personale në drejtim të Republikës së Kosovës hasë në vështirësi.

I rekomandojmë Qeverisë së Kosovës dhe Kuvendit të Kosovës, që si objektiv të vetin të kenë me prioritet procedimin dhe ratifikimin e Konventës 108 të vitit 1981.

Me miratimin dhe hyrjen në fuqi të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Ligjit për Qasje në Dokumente Publike, krijohet një gjendje e re juridike me kompetenca dhe përgjegjesi të reja të cilat i jepen Agjencisë.

Rekomandohet që Kuvendi dhe Qeveria ta mbështesin Agjencinë në aspektin financiar, pasi që pritet të kemi edhe shtim të numrit të stafit të cilin e presin punë dhe detyra shtesë, si përgatitjen dhe hartimin e akteve nënligjore për zbatimin e këtyre dy ligjeve, krijimin e inspektorateve të brendshme që do të mbikëqyrin zbatimin e legjislacionit përkatës, përmes kryerjes së inspektimeve dhe kontrolleve, shqiptimit të masave ndëshkuese përmes shqiptimit të drejtpërdrejtë të gjobave, të cilat janë paraparë në këto ligje.

Këto rekomandime mbështeten edhe në konkluzionet e nën-komitetit për Drejtësi, Liri dhe Siguri, qershor 2018, ku përfshinë alokimin e mjaftueshëm të burimeve njerëzore dhe financiare nga Kuvendi dhe Qeveria e Kosovës për Agjencinë.

## 7 Raporti Financiar

### 7.1 Përmbledhje të Zhvillimeve Kryesore për Buxhetin

Agjencia ka buxhetin e saj, i cili administrohet në mënyrë të pavarur në pajtim me ligjin. Buxheti final i Agjencisë përcaktohet nga Kuvendi i Kosovës, gjegjësisht kërkesa finale shqyrtohet nga Komisioni për Buxhet dhe Financa, duke respektuar planifikimin buxhetor të përcaktuar nga Ministria e Financave lidhur me Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve.

ASHMDHP, për vitin fiskal 2018, ka pasur buxhetin fillestar të ndarë sipas Ligjit për Buxhet në vlerë prej €364,067.00, bazuar në kërkesën e Minsitrit të Financave na është zvogëluar buxheti dhe si përfundim buxheti final i Agjencisë për vitin 2018 ka qenë €253,784.70.

ASHMDHP ka funksionuar me buxhetin final në vlerë prej €253,784.70, në këtë shpërndarje: paga dhe mëditje €120,139.36, mallra dhe shërbime €130,448.00, shërbime komunale €3,197.34.

Në vitin 2018, ASHMDHP ka shpenzuar rreth 86.98% të buxhetit të përgjithshëm apo €220,757.19 nga këto kategori: paga dhe mëditje 100.00% apo €120,139.36, mallra dhe shërbime 76.11% apo €99,285.90 dhe shërbime komunale 41.65% apo €1,331.93.

### 7.2 Përmbledhje për të Hyrat dhe Kategoritë e Veçanta të Shpenzimeve

- a) **Të hyrat** - Agjencia, në bazë të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka themeluar dhe mbanë regjistër të sistemit të dosjeve.





Brenda vitit 2018, dy (2) kontrollues kanë sjellur dy (2) njoftime për regjistrimin e sistemit të dosjeve, nga kontrolluesit e sektorit privat dhe publik. Duke e pasur parasysh se ligji është në plotësim ndryshim dhe në mungesë të inspektimit dhe kontrollit, nuk ka pasur njoftime për regjistrim nga të cilat janë gjeneruar të hyra.

- b) Pagat dhe mëditjet** - në kategorinë paga dhe mëditje kemi pasur buxhetin e ndarë në vlerë prej €120,139.36 dhe në vitin 2018 kemi shpenzuar rreth 100.00% të buxhetit apo €120,139.36. ASHMDHP ka 24 zyrtarë të lejuar për punësim, prej tyre 5 funksionarë publikë të emëruar nga Kuvendi, të cilët e kanë përfunduar mandatin e tyre dhe 19 nëntëmbëdhjetë shërbyes civilë. Në janar numri i të punësuarëve ka qenë 17 punonjës si dhe në dhjetor 17 punonjës. Fonde për paga ka pasur të mjaftueshme për këtë numër të punëtorëve, por me këto pozita të pakta nuk mund të funksionalizohet struktura organizative me tri departamente, e cila buron nga Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe ligjet tjera për ngritjen e kontrollit të brendshëm, realizimin e shpenzimeve dhe ngritjen e shkallëve për funksionalizimin e plotë të Agjencisë. Ne kemi kërkuar në vazhdimësi shtimin e numrit të zyrtarëve edhe për 9 pozita dhe rritjen e pagave bazuar në fushëveprimtarinë e veçantë të Agjencisë dhe punën e shumëfishtë me vendime shtesë që bëjnë zyrtarët e Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
- c) Mallra dhe Shërbime** - në kategorinë mallra dhe shërbime kemi pasur buxhetin final të ndarë në vlerë prej €130,448.00 dhe në vitin 2018 kemi shpenzuar €99,285.90 apo 76.11% të buxhetit. Gjatë vitit 2018 i kemi zvogëluar shpenzimet në çdo aspekt dhe kemi arritur që mos të kemi obligime që na ka përcjellë çdo vit nga viti 2011, kur edhe është themeluar Agjencia.
- d) Shpenzime Komunale** - në kategorinë shërbime komunale kemi pasur buxhetin final të ndarë në vlerë €3,197.34 dhe në vitin 2018 kemi shpenzuar €1,331.93 apo 41.65% të buxhetit.
- e) Investimet Kapitale** - Nuk kemi pasur buxhet dhe nuk kemi shpenzime në këtë kategori.
- f) Subvencionet dhe Transferet** - Nuk kemi pasur buxhet dhe nuk kemi shpenzime në këtë kategori.

### 7.3 Përmbledhje e Vërejtjeve Përfundimtare dhe Pikëpamjet për Zhvillimet e Ardhshme

Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka pasur buxhetin e ndarë prej €364,067.00 në fillim të vitit 2018, ndërsa pas rishikimit i ka mbetur buxheti prej €253,784.70.

Me këtë buxhet të ndarë dhe me tetëmbëdhjetë punonjës të lejuar, Agjencia nuk do të ketë mundësi të funksionalizohet e as të operacionalizojë sektorë të caktuar brenda saj, në përputhje me ligjin, këtë duke e pasur parasysh se ligji është në plotësim ndryshim ku pritet që të inkorporohet edhe qasja në dokumente zyrtare.

Sfidë e vazhdueshme mbetet zhvillimi i kapaciteteve njerëzore kur dihet që natyra e punës së Agjencisë dhe pamundësia e trajnimeve brenda vendit për zyrtarët mbrojtës të akredituar në institucionet publike dhe private; Funksionalizimi i strukturës organizative të Agjencisë (shtimi i



numrit të personelit); Ndryshimi i ligjit; Fuqizimi i Institucionit dhe dhënia e gjobave në mënyrë të drejtpërdrejtë.

### 7.3.1 Objektivat e Vazhdueshme

Mbikëqyrja e vazhdueshme e ligjshmërisë së përpunimit të të dhënave synohet të arrihet duke zhvilluar aktivitete në dy fusha:

- Edukimin e kontrollorëve;
- Ngritjen e vetëdijes së qytetarëve;
- Harmonizimin e legjislacionit me *Acquis Communautaire* të BE-së;
- Zbatimin e drejtpërdrejtë të ligjit përmes inspektimeve dhe kontrolleve;
- Trajtimin e ankesave;
- Ngritjen e kapaciteteve

Zhvillimi i hovshëm në menaxhimin e të dhënave personale në teknologji dhe pamundësia që të jemi në hap me kohën dhe realizimin e objektivave bazë që përmbushin fushëveprimtarinë e Agjencisë – vet mungesa buxhetore në kategorinë mallra dhe shërbime, përcakton projektet të cilat nuk mund të realizojë vet Agjencia. Nevoja për organizimin e fushatave senzibilizuese të vazhdueshme edhe në fushat tjera përveç arsimit – si në shëndetësi, shërbime për qytetarë dhe segmente tjera - buxheti është element i rëndësishëm për funksionimin e Agjencisë dhe shtimin e personelit në departamentet që fushëveprimtaria e tyre buron nga Ligji funksional 03/L-172 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.



#### 7.4 Tabelat 4– Detajet e Shpenzimeve. Sipas Kodeve Ekonomike

##### 7.4.1 Shpenzimet e Përgjithshme

Kodi Ekonomik	Kategoria Ekonomike	Buxheti dhe shpenzimet 2016			Buxheti vjetor me ligjin e buxhetit (2018)	Buxheti me rishikim 2018	Buxheti përfundimtar 2018	Shpenzimet deri më 31 dhjetor 2018	Zotimet deri më 31 dhjetor 2018	Buxheti i zotuar (në %)	Buxheti i shpenzuar (në%)
		Buxheti (2017)	Shpenzimet (2017)	% e shpenzimit							
1	2	3			4	5	6	7	8	9	10
11000	Paga dhe Mëditje	166.344.01	117,810.83	70,82%	227,169.00	120.139.36	120.139.36	120.139.36	120.139.36	100.00%	100.00%
13000	Mallra dhe Shërbime	117,000.00	94,055.48	80,38%	130,448.00	130,448.00	130,448.00	99,285.90	111,900.30	85.78%	76.11%
13200	Shpenzime Komunale	1,450.00	421.49	29,03%	6,450.00	3,147.34	3,147.34	1,331.93	1,785.09	56.71%	42.31%
21000	Subvencione dhe Transfere	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
30000	Investimet Kapitale	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
	<b>Gjithësej</b>	<b>284,794.01</b>	<b>212,287.80</b>	<b>74,54%</b>	<b>364,067.00</b>	<b>253,784.70</b>	<b>253,784.70</b>	<b>220,757.19</b>	<b>233,824,75</b>	<b>92.13%</b>	<b>86.98%</b>



## 7.4.2 Mallra dhe Shërbime

		Buxheti 2017			Buxheti 2018		
13000	MALLRA DHE SHËRBIME Emri i kategorisë ekonomike	Planifikimi 2017	Shpenzimet në (2017)	% e shpenzimit	Planifikimi 2018	Shpenzimet në (2018)	% e shpenzimit
	<b>Gjithsej Mallra dhe Shërbime</b>	<b>117.000,00</b>	<b>94.055,48</b>	<b>80,38</b>	<b>130,448.00</b>	<b>99.285.90</b>	<b>76.11</b>
<b>13100</b>	<b>SHPENZIMET E UDHËTIMIT (NEN TOTALI)</b>	<b>41.000,00</b>	<b>31.853,54</b>	<b>77,69</b>	<b>43.001,00</b>	<b>48.577,58</b>	<b>112.96</b>
13130	Shpenzimet e udhëtimit zyrtar brenda vendit	-	-	-	-	-	-
13131	Meditja e udhëtimit zyrtar brenda vendit	-	-	-	-	-	-
13132	Akomodimi gjatë udhëtimit zyrtar brenda vendit	-	-	-	-	-	-
13133	Shpenzimet tjera të udhëtimit zyrtar brenda vendit	-	-	-	-	-	-
13140	Shpenzimet e udhëtimit zyrtar jashtë vendit	<b>11.000,00</b>	<b>8.168,49</b>	<b>74,26</b>	<b>8.000,00</b>	<b>6.782,37</b>	<b>84.77</b>
13141	Meditja e udhëtimit zyrtar jashtë vendit	<b>18,500,00</b>	<b>14.792,88</b>	<b>79,96</b>	<b>20.000,00</b>	<b>22.366,15</b>	<b>111.83</b>
13142	Akomodimi gjatë udhëtimit zyrtar jashtë vendit	<b>8.500,00</b>	<b>6.879,91</b>	<b>80,94</b>	<b>12.001,00</b>	<b>16.652,31</b>	<b>138.75</b>
13143	Shpenzimet tjera të udhëtimit zyrtar jashtë vendit	<b>3.000,00</b>	<b>2.011,79</b>	<b>67,06</b>	<b>3.000,00</b>	<b>2.776,75</b>	<b>92.55</b>
<b>1330</b>	<b>SHËRBIMET E TELEKOMUNIKIMIT (NËN TOTALI)</b>	<b>6.700,00</b>	<b>4.341,03</b>	<b>64,79</b>	<b>8.050.00</b>	<b>3.473,06</b>	<b>43.14</b>
13310	Shpenzimet për internet	<b>100,00</b>	<b>77,73</b>	<b>77,73</b>	<b>950.00</b>	<b>0.00</b>	<b>-</b>
13320	Shpenzimet e telefonisë mobile	<b>6.500,00</b>	<b>4.260,00</b>	<b>65,54</b>	<b>6.600,00</b>	<b>3.473,06</b>	<b>52.62</b>



13330	Shpenzimet postare	100,00	3,30	3,30	500,00	0.00	0.00
13340	Shpenzimet e përdorimit të kabllit	-	-	-	-	-	-
<b>1340</b>	<b>SHPENZIMET PËR SHËRBIME (NËN TOTALI)</b>	<b>24.280,00</b>	<b>22.336,59</b>	<b>91,99</b>	<b>27.347,00</b>	<b>20.560.52</b>	<b>75.18</b>
13410	Shërbimet e arsimit dhe trajnimit	14.000,00	13.050,00	93,21	15.000,00	14.950,00	99.66
13420	Shërbimet e përfaqësimit dhe avokaturës	-	-	-	347,00	0.00	0.00
13430	Shërbime të ndryshme shëndet.	-	-	-	-	-	-
13440	Shërbime të ndryshme intelektuale dhe këshilldhënëse	2.000,00	1.720,30	86,02	1.000,00	0.00	0.00
13450	Shërbime shtypje-jomarketing	-	-	-	1.000,00	340	34
13460	Shërbime Kontraktuese Tjera	8.280,00	7.566,29	91,38	4.500,00	4.520,52	100.45
13470	Shërbime Teknike	-	-	-	-	-	-
13480	Shpenzimet për Anëtarësim	-	-	-	500,00	750	150

<b>1350</b>	<b>BLERJE E MOBILJEVE DHE PAJISJEVE (ME PAK SE €1000) (NEN TOTALI)</b>	<b>00.00</b>	<b>00,00</b>	<b>00,00</b>	<b>4.500,00</b>	<b>00,00</b>	<b>00,00</b>
13501	Mobilje (më pak se €1000)	00.00	0,00	0,00	1.500,00	0,00	0,00
13502	Telefona (më pak se €1000)	-	-	-	-	-	-
13503	Kompjuterë (më pak se €1000)	-	-	-	-	-	-
13504	Harduer për teknologji informative (më pak se €1000)	-	-	-	1.500,00	0,00	0,00
13505	Makina fotokopjuese (më pak se €1000)	-	-	-	-	-	-



13506	Pajisje speciale mjekësore (më pak se 1000 euro)	-	-	-	-	-	-
13507	Pajisje të shërbimit policor (më pak se €1000)	-	-	-	-	-	-
13508	Pajisje trafiku (më pak se €1000)	-	-	-	-	-	-
13509	Pajisje tjera (më pak se €1000)	-	-	-	1.500,00	0,00	0,00
<b>1360</b>	<b>BLERJE TJERA-MALLRA DHE SHËRBIME (NËNTOTAL)</b>	<b>2.970,00</b>	<b>2.835,49</b>	<b>95,47</b>	<b>6.000,00</b>	<b>0,00</b>	<b>0,00</b>
13610	Furnizime për zyrë	2.970,00	2.835,49	95,47	6.000,00	0,00	0,00
13620	Furnizime me ushqim dhe pije (jo dreka zyrtare)	0,00	375,00	0,00	0,00	0,00	0,00
13630	Furnizime mjekësore	-	-	-	-	-	-
13640	Furnizime pastrimi	-	-	-	-	-	-
13650	Furnizim me veshmbathje	-	-	-	-	-	-
13660	Akomodimi	-	-	-	-	-	-
<b>1370</b>	<b>DERIVATET DHE LËNDËT DJEGËSE (NËNTOTALI)</b>	<b>11.000,00</b>	<b>9.614,08</b>	<b>87,40</b>	<b>11.000,00</b>	<b>8,689.93</b>	<b>78.99</b>
13710	Vaj	-	-	-	-	-	-
13720	Naftë për ngrohje qendrore	-	-	-	-	-	-
13730	Vaj për ngrohje	-	-	-	-	-	-
13740	Mazut	-	-	-	-	-	-
13750	Qymyr	-	-	-	-	-	-
13760	Dru	-	-	-	-	-	-
13770	Derivate për gjenerator	-	-	-	-	-	-
13780	Karburant për vetura	11.000,00	9.614,08	87,40	11.000,00	8,689.93	78.99



<b>1380</b>	<b>LLOGARITË E AVANSIT (NËNTOTAL)</b>	-	-	-	-	-	-
13810	Avans për para të imta (p.cash)	-	-	-	-	-	-
13820	Avans për udhëtime zyrtare	-	-	-	-	-	-
13821	Avans	-	-	-	-	-	-
13830	Avans për mallra dhe shërbime	-	-	-	-	-	-
13850	Avans-për ambasadat	-	-	-	-	-	-
<b>1390</b>	<b>SHËRBIMET FINANCIARE (NËNTOTALI)</b>	-	-	-	-	-	-
13911	Provizion Bankar-Banka Qendrore	-	-	-	-	-	-
13912	Provizion Bankar-Raiffeisen Bank	-	-	-	-	-	-
13913	Provizion Bankar-Procredit Banke	-	-	-	-	-	-
13915	Provizion Bankar-Banka Private e Biznesit	-	-	-	-	-	-
13916	Provizion Bankar-Banka Ekonomike	-	-	-	-	-	-
13917	Provizion Bankar-NLB Banka Prishtina	-	-	-	-	-	-
13918	Provizion për Tarifa të Ndryshme	-	-	-	-	-	-
13940	KPA-Provizioni Bankar	-	-	-	-	-	-

<b>1395</b>	<b>SHËRBIMET E REGJISTRIMIT DHE SIGURIMEVE (NËNTOTALI)</b>	<b>4.600,00</b>	<b>3.447,89</b>	<b>74,95</b>	<b>4.600,00</b>	<b>2.992,17</b>	<b>65.04</b>
13950	Regjistrimi i automjeteve	1.000,00	905,00	90,50	1.000,00	735,00	73.5
13951	Sigurimi i automjeteve	3.500,00	2.452,89	70,08	3.500,00	2.187,17	62.49
13952	Taksa komuale e regjistrimit të automjeteve	100,00	90,00	90,00	100,00	70,00	70,00
13953	Sigurimi i ndërtesave dhe tjera						



<b>1400</b>	<b>MIRËMBAJTJA (NËNTOTALI)</b>	<b>10.000,00</b>	<b>6.698,36</b>	<b>66,98</b>	<b>13.000,00</b>	<b>6.868,74</b>	<b>52.83</b>
14010	Mirëmbajtja dhe riparimi i automjete.	9.000,00	6.204,36	68,94	9.000,00	6.713,74	74.59
14020	Mirëmbajtja e ndërtesave	-	-	-	-	-	-
14021	Mirëmbajtja e ndërtesave të banimit	-	-	-	-	-	-
14022	Mirëmbajtja e ndërtesave administrativeafariste	-	-	-	-	-	-
14023	Mirëmbajtja e shkollave	-	-	-	-	-	-
14024	Mirëmbajtja e objekteve shendetesore	-	-	-	-	-	-
14030	Mirëmbajtja e autorrugëve	-	-	-	-	-	-
14031	Mirëmbajtja e autorrugëve regjionale	-	-	-	-	-	-
14032	Mirëmbajtja e autorrugëve lokale	-	-	-	-	-	-
14040	Mirëmbajtja e Teknologjisë Informative	1.000,00	494,00	49,40	3.500,00	155,00	4.42
14050	Mirëmbajtja e mobileve dhe paisjeve	-	-	-	500,00	0,00	0,00





<b>1410</b>	<b>QIRAJA (NËNTOTALI)</b>	<b>200,00</b>	<b>0,00</b>	<b>0,00</b>	<b>200,00</b>	<b>0,00</b>	<b>0,00</b>
14110	Qiraja për ndërtesa	-	-	-	-	-	-
14120	Qiraja për tokë	-	-	-	-	-	-
14130	Qiraja për paisje	<b>200,00</b>	<b>0,00</b>	<b>0,00</b>	<b>200,00</b>	<b>0,00</b>	<b>0,00</b>
14140	Qiraja për makineri	-	-	-	-	-	-
14150	Qiraja për përdorime tjera hapësinore	-	-	-	-	-	-
<b>1420</b>	<b>SHPENZIMET E MARKETINGUT (NËNTOTALI)</b>	<b>1.500,00</b>	<b>500,00</b>	<b>33,33</b>	<b>3.000,00</b>	<b>0,00</b>	<b>33,33</b>
14210	Reklammat dhe konkurset	<b>1.500,00</b>	<b>500,00</b>	<b>33,33</b>	<b>3.000,00</b>	<b>0,00</b>	<b>33,33</b>
14220	Botimet e publikimeve	-	-	-	-	-	-
14230	Shpenzimet për informim publik	-	-	-	-	-	-
<b>1430</b>	<b>SHPENZIMET E PËRFAQËSIMIT (NËNTOTALI)</b>	<b>14.750,00</b>	<b>12.428,50</b>	<b>84,26</b>	<b>14.750,00</b>	<b>8,123,90</b>	<b>55,07</b>
14310	Drekat zyrtare	<b>14.000,00</b>	<b>12.215,70</b>	<b>87,26</b>	<b>14.000,00</b>	<b>8,123,90</b>	<b>58,02</b>
14320	Drekat zyrtare jasht vendit	<b>750,00</b>	<b>212,80</b>	<b>28,37</b>	<b>750,00</b>	<b>0,00</b>	<b>0,00</b>
<b>1440</b>	<b>SHPENZIME VENDIME TE GJYKATAVE (NËNTOTALI)</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
14410	Shpenzime-vendime te gjykatave	-	-	-	-	-	-
<b>1700</b>	<b>SERVISIMI I BORXHIT (NËNTOTALI)</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
17000	Pagesa e borxhit qeveritar	-	-	-	-	-	-

**7.4.3 Shpenzimet Komunale**

		Buxheti 2017			Buxheti 2018		
1320	Shpenzime Komunale	Planifikimi 2017	Shpenzimet (2017)	% e shpenzimit	Planifikimi 2018	Shpenzimet (2018)	% e shpenzimit
	Gjithsej Shpenzime Komunale	1.450,00	421,49	29,07	3.197,34	1.331,93	41.65
1320	SHPENZIME KOMUNALE (NËNTOTALI)	1.450,00	421,49	29,07	3.197,34	1.331,93	41.65
13210	Rryma	-	-	-	-	-	-
13220	Uji	-	-	-	-	-	-
13230	Mbeturinat	-	-	-	-	-	-
13240	Ngrohja qendrore	-	-	-	-	-	-
13250	Shpenzimet telefonike	1.450,00	421,49	29,07	3.197,34	1.331,93	41.65

**7.4.4 Investimet Kapitale**

Agjencia nuk ka pasur projekte kapitale gjatë viteve 2015, 2016, 2017 dhe 2018.



#### 7.4.5 Subvencione dhe Transfere

Agjencia nuk ka pasur buxhet të paraparë në Subvencione dhe Transfere

#### 7.4.6 Personeli dhe Struktura e Pagave<sup>1</sup>

Totali i shpenzimeve të pagave dhe meditjeve për vitin 2018 ka qenë 120.139,36 €.

Niveli	Pozitat e aprovuara me Ligjin për Buxhet Buxhetit për Vitin 2018	Pozitat e plotësuara	Buxheti i aprovuar me Ligjin e e Buxhetit për Paga dhe Meditje	Buxheti i shpenzuar për paga deri me 31 dhjetor 2018	Totali i pagesave shtesë	Numri i përgjithshëm i të punësuarve që pranojnë pagesa shtesë	a). Orari i punës (orar i plotë/gjysëm orari dhe b). Të specifikohet lloji i pagesës shtesë
1	2	3	4	5	6	7	8
Niveli i Bordit	5	0	82,873.41		0	0	Orari i plotë
Niveli i menaxhmentit të lartë	1	1	14,922.45	14,722.45	0	0	Orari i plotë
Niveli i menaxhmentit	6	6	53,816.11	39,214.63	1,200.00	1	Orari i plotë
Niveli profesional	10	8	65,498.77	53,808.02	0	0	Orari i plotë
Niveli mbështetës	2	2	11,194.26	11,194.26	0	0	Orari i plotë
<b>Totali</b>	<b>24</b>	<b>17</b>	<b>228,305.00</b>	<b>118,939.36</b>	<b>1,200.00</b>		Orari i plotë

118,939.36+1,200.00= 120,139,36 euro (totali pagave 2018)

<sup>1</sup>Këshilli i Agjencisë ka përfunduar mandatin me 23/06/2016.



## 8 Raportimi rreth Adresimit të Rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm

Bazuar në raportin e Auditimit për raportin vjetor të Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të dhënave personale, raporti me datë 30/04/2018 me nr. Ref. 597, i cili ka nxjerr pesë (5) rekomandime për ASHMDHP-në, dhe i cili është bazuar në pasqyrat financiare, qeverisjen dhe menaxhimin financiar dhe të kontrollit, vlen të ceket opinionin e Auditorit të Përgjithshëm si **'Opinion i pamodifikuar'**, mbi shumicën e rekomandimeve të cilat kanë ardhë si mungesë e personelit kompetent në fusha administrative dhe financiare, ndryshimit të ligjit Nr.04/L-072 për prokurimin publik të Republikës së Kosovës gjegjësisht neni 21A, caktimit dytësor me vendime shtesë për personelin me U.D për pozicione pune tjera të cilat mungojnë në Departmentin e Administratës dhe Shërbimeve të Përgjithshme.

Sfidë e vazhdueshme mbetet mungesa e kapaciteteve njerëzore brenda Agjencisë, andaj ne kemi kërkuar në vazhdimësi rritjen e numrit të zyrtarëve bazuar në fushëveprimtarinë e veçantë të Agjencisë dhe punën e shumëfishtë me vendime shtesë apo (U.D) që bëjnë zyrtarët e Agjencisë.

ASHMDHP tani ka nëntëmbëdhjetë (19) shërbyes civil të lejuar, të cilët me detyrë parësore janë të caktuar në departamentet operacionale të punës dhe njëkohësisht ASHMDHP funksionon si organ i pavarur buxhetor duke i realizuar të gjitha procedurat e pavarur (përveç prokurimit i cili realizohet nga AQP, bazuar në ndryshimet e fundit të ligjit të prokurimit neni 21A).

Për të funksionuar si organ i pavarur buxhetor dhe për të zbatuar rekomandimet nga raporti i Auditimit nga rekomandimi 1-5 e posaqërisht rekomandimi nr. 1 ku potencohet se nga themelimi disa nga pozicionet përgjegjëse financiare mbulohen nga zyrtar me detyra dytësore apo U.D., neve na duhen edhe katër (4) pozita pune të cilat parashihen bazuar në ligjin e financave dhe përgjegjësiive publike si dhe manuelin e thesarit, për të cilat ne kemi shterrur mundësitë tona menaxheriale dhe kemi kërkuar në vazhdimësi rritjen e numrit të personelit nga Ministria e Financave dhe Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Menaxhmenti i ASHMDHP-së ka monitoruar në vazhdimësi adresimin e rekomandimeve të dhëna në vitin 2018 dhe ka bërë progres të theksuar në këtë drejtim. Për një periudhë të shkurtër kohore kemi arritur të adresojmë të gjitha rekomandimet. Kjo tregon gatishmërinë dhe angazhimin e menaxhmentit për të përmirësuar kontrollet në vazhdimësi.

Raporti i auditimit për PVF-të e ASHMDHP-së, ka rezultuar me pesë rekomandime. Prej tyre të gjitha janë adresuar plotësisht nga ana jonë, ndërsa një rekomandim është në proces të zbatimit nga ana e MAP-it lidhë me pasuri pasë që edhe ata janë duke e rishikuar sistemin.

Procesi lidhur me adresimin e rekomandimeve për menaxhmentin e ASHMDHP-së ka qenë mjaft i ngarkuar pasi që mungesa e personelit pamundëson delegimin e kompetencës tek zyrtarët profesional në mungesë të tyre. Ne në vazhdimësi kemi kërkuar rritjen e numrit të zyrtarëve dhe do të shterrim të gjitha mundësitë tani pasi që me ligjin e ri do të ristrukturohet Agjencia, është shtuar veprimtaria dhe tani do të kemi në zbatim edhe ligjin për qasje në dokumente publike – shkalla e dytë e ankesës. Me (41) zyrtarë të lejuar për vitin 2020 nuk



mund të funksionalizohet struktura organizative e cila buron nga Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, ligji për qasje në dokumente publike dhe ligjet tjera për ngritjen e kontrollit të brendshëm, realizimin e shpenzimeve dhe ngritjen e shkallëve hierarkike.

Raporti për veprimet e ndërmarra dhe të propozuara për gjetjet dhe rekomandimet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin paraprak.



Tabela:6 - Rekomandimet e Auditorit

Nr	Rekomandimi ose gjetja	Veprimi i ndërmarrë ose propozuar	Afati zbatimit	Efekti	Vlerësimi i Rrezikut
1	<p>Rekomandimi 1: Drejtori i Përgjithshëm duhet të siguroj që pozitat kyçe të lartcekura të janë të aprovuara me buxhet dhe sipas kërkesave të LMFP-së dhe të parandalojë ushtrimin e këtyre funksioneve me rotacion dhe nga personeli jo adekuat, me qëllim të përmirësimit të aktiviteteve në këto funksione.</p>	<p>Menaxhmenti i Agjencisë, çdo vit ka kërkuar shtimin e numrit të personelit, bazuar në Rregulloren për Organizim të Brendshëm dhe Fushë veprimtarinë e agjencisë. Agjencia është organ i pavarur buxhetor dhe kërkesat për shtim të numrit të personelit janë dërguar përmes kornizës afatmesme të shpenzimeve në Ministrinë e Financave; Raportit Vjetor të Punës të dërguar Komisionit Parlamentar për Siguri; dhe përmes kërkesave për shtim të numrit të personelit drejtuar Komisionit për Buxhet dhe Financa të dërguar çdo fund vit para aprovimit të buxhetit. Menaxhmenti ka shterur mundësitë e veta për realizimin e këtij objekti dhe aktualisht jemi në fazën e kostimit financiar të projektligjit të ri për mbrojtjen e të dhënave personale, pas miratimit të të cilit presim plotësimin e pozitive të munguara në financa. Gjithashtu edhe gjatë vitit 2018 ne do të shterrim të gjitha mundësitë dhe do të kërkojmë shtimin e personelit.</p>	<p>Qershor 2018 Prill 2019</p>	<p>Rekomandim i përbushur</p>	<p>Për pozitën e ZKF, kemi bërë transfer paralel. Ndërsa për pozitën e Certifikuesit kemi hapur konkurs të brendshëm, presim të plotësohet Brenda muajit shkurt 2019. Kështu që ky për momentin është rekomandim pjesërisht I zbatuar. Në muajin shkurt presim të zbatohet plotësisht, kjo pas përfundimit të konkursit të brendshëm.</p>



2	<p>Rekomandimi 2: Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurohet që para se të aprovoj pushimet pa pagesë t'i ketë shqyrtuar dëshmitë relevante në mënyrë që vendimi të jetë në përputhje me rregulloren për dhënien e pushimit pa pagesë.</p>	<p>Zyrtari në fjalë ka marrë pushim pa pagesë në muajin dhjetor 2017. I njëjti, në kërkesën e tij, ka bashkëlidhur trajnimet fillestare të përfunduara për aplikim dhe dokumentet tjera që e arsyetojnë kërkesën për pushim pa pagesë me qëllim të zhvillimit profesional në aspektin akademik. I njëjti, siç ka sqaruar, bazuar në vonesat e njohjes së diplomës nga shteti ku ka vendosur të vazhdojë studimet, ka dhënë dorëheqje vullnetare nga pozita që mbante në Agjenci.</p>	<p>Janar-Mars 2018 (i plotësuar)</p>	<p>Rekomandim përmbushur</p> <p>i</p>	<p>Rekomandim I plotësuar, nuk ka rrezik. Kjo pas veprimit të menaxhmentit zyrtari në fjalë ka dhënë dorëheqje nga pozita.</p>
3	<p>Rekomandimi 3 Drejtori i Përgjithshëm duhet të siguroj se kontrollet në procesin e ekzekutimit të pagesave janë duke u monitoruar në vazhdimësi. Po ashtu, që malli/fatura nuk duhet pranuar para se të jetë procesuar urdhër blerja.</p>	<p>Pikërisht mungesave e pozicioneve relevante në financa për pesë vite me radhë dhe angazhimi me detyra dytësore të zyrtarëve që nuk janë të fushës relevante, kryerja e procedurave të prokurimit nga Agjencia Qendrore e Prokurimit, si dhe mungesa e alokimeve buxhetore për realizimin e projekteve financiare, kanë shkaktuar vonesa në realizimin e pagesave, por të cilat nuk kanë shkaktuar implikime shtesë buxhetore.</p> <p>Gjatë vitit 2018 do të caktojmë personelin, pavarësisht që personeli përgjegjës mungon dhe do të tentojmë që përmes trajnimeve, personeli me punë dytësore të profesionalizohen dhe të jenë përgjegjës për veprimet e tyre.</p>	<p>Janar-Dhjetor 2018</p>	<p>Rekomandim i përmbushur</p>	<p>Rekomandim I plotësuar, Gjithashtu për vitin 2018 nuk kemi pasur ndonjë vonesë në pagesa dhe pas transferit të ZKF, kemi filluar të bëjmë kontrolle më të mëdha dhe nuk presim të kemi vonesa.</p>



4	<p>Rekomandimi 4 Drejtori i Përgjithshëm duhet të siguroj funksionalizimin e sistemit e-pasuria dhe trajnimin e zyrtarit të pasurive nga ana e MAP-it.</p>	<p>Agjencia, si institucion i pavarur, i raporton Kuvendit. Për gati shtatë vite funksionim, ka vetëm 18 shërbyes civilë, objektiv primar i punës së të cilëve është zbatimimi i Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Edhe për këtë fushë, ne nuk kemi zyrtar të pasurisë, por me vendim shtesë është caktuar zyrtari i TI-së, i cili është certifikuar për sistemin e pasurisë së Agjencisë për pajisjet mbi €1000, kurse sa i përket regjistrimit të pasurisë me vlerë nën €1000, e kemi mbajtur në një bazë të të dhënave në Agjenci, e cila gjatë këtij viti do të përfshihet brenda sistemit të e-pasurisë. Kërkesa për hapjen e llogarive në MAP-ASHI ishte dërguar në vitin 2014, 2015 dhe 2016. Ndërsa së fundi e kemi dërguar kërkesën për certifikim të zyrtarit të pranimit që të bëjë futjen e të dhënave për pasurinë më pak se 1000€.</p>	<p>Qershor 2018 Prill 2019</p>	<p>Rekomandim i përmbushur</p>	<p>Në fund të vitit 2018 kemi autorizuar zyrtarin e ri që të fillojë me procedurat e futjes të pasurisë në sistemin e-pasuria. Pas vlerësimit dhe evidentimit të pasurisë nga komisionet përkatëse, zyrtari ka bërë kërkesë për çasje pas trajnimit të përfunduar dhe ka filluar me futjen e pasurisë. Problemi i mos përmbushjes të rekomandimit ishte se zyrtari I certifikuar ka dhënë dorëheqje nga puna, dhe është dashtë të gjendet një zyrtarë alternativ.</p>
5	<p>Rekomandimi 5 Drejtori i Përgjithshëm duhet të rishikoj dhe analizoj shkaqet e rekomandimeve të pazbatuara, dhe të përcaktojë një afat të ri kohor për zbatimin e rekomandimeve, përfshirë edhe stafin llogaridhënës. Implementimi duhet të monitorohet në vazhdimësi.</p>	<p>Këtu duhet të cekë se progresi në zbatimin e rekomandimeve është i kufizuar dhe i kushtëzuar nga shtimi i personelit adekuat në funksionet relevante brenda departamentit të shërbimeve të përgjithshme. Gjithashtu duke i pas parasysh dhe ndryshimet ligjore ne veç kemi filluar me përmbushjen e tyre, gjë që do të ndodh me ristrukturim dhe ndarje të përgjegjësive për secilën punë zyrtarëve si punë primare. Ne gjithashtu gjatë këtij viti do të tentojmë që të përmbushim obligimet tona pavarësisht që mungon personeli përgjegjës bazuar në rekomandimin 1.</p>	<p>Qershor 2018 Prill 2019</p>	<p>Rekomandim i përmbushur</p>	<p>Drejtori I përgjithshëm për rekomandimet e pazbatuara ka dhënë një afat deri në muajin prill 2019 që do të përmbushen, momentalisht jemi në pritje të fillimit të ndryshimit të struktuarës të ASHMDHP-së në AIP, kjo pas miratimit të ligjit nga kuvendi. Agjencia ka filluar me palnifikimin e personelit për secilën pozitë të këtyre punëve primare dhe me këtë do të përmbushet apo zbatohet rekomandimi.</p>